



UDHËZUES

Për Pjesëmarrjen Publike të
Aktorëve Lokal

UDHËZUES PËR PJESËMARRJEN PUBLIKE NË NIVEL LOKAL

Autor

Elton Qendro

Redaktoi

Olsi Nika, Eni Hoxha
EcoAlbania

Kopertina

Fotografia © Gani Bego

Viti

2026

© 2026 EcoAlbania

Ky udhëzues është hartuar në kuadër të projektit “Menaxhimi i qëndrueshëm i korridoreve ekologjik në zonën e Polis-Valamarë-Rungajë-Moravë-Gramoz”, zbatuar nga EcoAlbania dhe me financim të PONT. Mbështetja e PONT për përgatitjen e këtij botimi nuk përbën një miratim të përmbajtjes që pasqyron, vetëm pikëpamjet e autorëve, dhe PONT nuk mund të jetë përgjegjës për çdo përdorim të informacionit që përmban.

PARATHËNIE

Ky udhëzues është hartuar për të ndihmuar bashkitë dhe aktorët lokalë në Shqipëri të planifikojnë, zhvillojnë dhe vlerësojnë procese të efektshme të pjesëmarrjes publike në vendimmarrje, me fokus të veçantë në menaxhimin e qëndrueshëm të korridoreve ekologjike në zonën Polis–Valamarë–Rungajë–Moravë–Gramoz (CCA – Connectivity Conservation Area). Ai përfaqëson një instrument praktik për zyrtarët vendorë, këshillat bashkiakë, organizatat e shoqërisë civile dhe komunitetin lokal për të promovuar transparencë, gjithëpërfshirje dhe llogaridhënie në vendimmarrje, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe angazhimet ndërkombëtare.

Udhëzuesi ka për qëllim të rrisë kapacitetet e bashkive për të organizuar dhe lehtësuar procese të rregullta të pjesëmarrjes publike, të ofrojë mjete praktike, shembuj të mirë dhe modele të zbatueshme për aktorët lokalë, si dhe të nxisë ndërveprim të qëndrueshëm ndërmjet institucioneve, komunitetit dhe grupeve të interesit në funksion të mbrojtjes së natyrës dhe zhvillimit të qëndrueshëm vendor.

Udhëzuesi mbështetet në një **analizë të gjerë të kuadrit ligjor** kombëtar, duke përfshirë Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin e Procedurave Administrative, ligjet për vetëqeverisjen vendore, për informimin dhe konsultimin publik, për mjedisin, zonat e mbrojtura dhe planifikimin e territorit. Një vend të veçantë zënë edhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, si Konventa e Aarhus-it, Konventa e Espoo-s dhe Karta Evropiane për Vetëqeverisjen Vendore. Gjithashtu, udhëzuesi përfshin një analizë të qartë të rolit të bashkive dhe njësisë të qeverisjes vendore në sigurimin e pjesëmarrjes, si dhe të aktorëve të tjerë si administratat e zonave të mbrojtura, OSHC-të, komuniteti lokal, institucionet arsimore dhe sektori privat.

Një pjesë qendrore e udhëzuesit i kushtohet **formave dhe mekanizmave të pjesëmarrjes publike**, duke sqaruar llojet e pjesëmarrjes, nivelet e saj sipas shkallës së ndikimit qytetar në vendimmarrje (bazuar në modele të tilla si ai i Arnstein apo klasifikimi i OECD), dhe mekanizmat

praktikë të përdorshëm në kontekste të ndryshme vendore. Udhëzuesi strukturohet rreth një procesi të detajuar me shtatë hapa për organizimin e pjesëmarrjes: nga përcaktimi i qëllimit dhe identifikimi i palëve të interesuara, deri te analiza e komenteve dhe vlerësimi i ndikimit të pjesëmarrjes në vendimmarrje. Çdo hap shoqërohet me përshkrim praktik, shembuj konkretë dhe rekomandime për zbatim në nivel vendor.

Për më tepër, dokumenti **përfshin tabela krahasuese, raste studimore dhe shembuj praktikë** nga Shqipëria dhe vende të tjera, që pasqyrojnë mënyra të ndryshme të angazhimit publik si konsultimet tradicionale, shkenca qytetare, buxhetimi me pjesëmarrje, proceset deliberative, platforma digjitale dhe mjetet për monitorim qytetar. Në pjesën e fundi, udhëzuesi ofron dy shtojca shumë praktike: një listë kontrolli për bashkitë për planifikimin e pjesëmarrjes dhe një model për një akt bashkiak që kalon në konsultim publik.

Gjatë procesit të hartimit të këtij udhëzuesi janë zhvilluar konsultime me përfaqësues të bashkive, administratave të zonave të mbrojtura dhe organizatave të shoqërisë civile, të cilat evidentuan se, ndonëse ekziston një kuadër ligjor i konsoliduar për pjesëmarrjen publike, në praktikë proceset e konsultimit shpesh zhvillohen në mënyrë formale, me përfshirje të kufizuar dhe ndikim të pamjaftueshëm në vendimmarrje. Këto gjetje kanë shërbyer si bazë për forcimin e qasjes praktike të udhëzuesit dhe për theksimin e nevojës për konsultime gjithëpërfshirëse, transparente dhe të zhvilluara në faza të hershme të proceseve vendimmarrëse.

Ky udhëzues është hartuar nga organizata EcoAlbania në kuadër të projektit “Menaxhimi i qëndrueshëm i korridoreve ekologjike në zonën Polis–Valamarë–Rungajë–Moravë–Gramoz”, me mbështetjen financiare të Prespa-Ohrid Nature Trust (PONT). Ai përfaqëson një kontribut të rëndësishëm për forcimin e qeverisjes mjedisore, promovimin e pjesëmarrjes qytetare dhe ruajtjen e natyrës në Shqipëri.

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	3
LISTA E FIGURAVE.....	2
LISTA E TABELAVE.....	2
LISTA E KUTIVE	2
1. HYRJE.....	3
1.1 Qëllimi dhe përdorimi i udhëzuesit	3
1.2 Pse pjesëmarrja publike në korridoret ekologjike është thelbësore	4
1.3 Roli i aktorëve lokale dhe ndërveprimi i tyre.....	5
2. KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL.....	8
2.1 Legjislacioni Shqiptar për Mjedisin dhe Pjesëmarrjen Publike	8
2.2 Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj	11
2.3 Roli i Bashkive dhe NJQV dhe strukturave mbështetëse.....	12
3. FORMAT DHE MEKANIZMAT E PJESËMARRJES PUBLIKE	13
3.1 Llojet dhe nivelet e pjesëmarrjes publike.....	13
3.2 Procesi i pjesëmarrjes publike në menaxhimin e korridoreve ekologjike Polis–Valamarë–Rungajë–Moravë–Gramoz.	16
4. MJETET PRAKTIKE TË PJESËMARRJES PUBLIKE	19
4.1 Qasja në Informacion dhe të Dhëna	20
4.2 Konsultimi Publik.....	21
4.3 Inovacioni, mbledhja e ideve, Hakathonet dhe Sfidat Publike.....	22
4.4 Shkenca Qytetare	23
4.5 Buxhetimi me pjesëmarrje	26
4.6 Proceset përfaqësuese (deliberative)	27
KREU 5. PRAKTIKA TË MIRA DHE MODELE FRYMËZUESE	29
5.1 Shembuj evropiane të pjesëmarrjes në menaxhim mjedisor	29
5.2 Përvoja të suksesshme në Shqipëri dhe rajon	31
Referenca.....	32
Shtojca A: Listë kontrolli për bashkitë për planifikimin e procesit të pjesëmarrjes publike në zonën e Korridorit.....	1
Shtojca B: Modeli i procedurave të brendshme e një akti bashkiak që kalon në konsultim publik.....	6

<i>Shtojca C: Fletë Kontrolli për Pjesëmarrjen Publike në nivel vendor</i>	8
<i>Shtojca D: Kuti Studimore për bashkëpunimin e bashkive për shpalljen e biokoridor-it si Park Natyror Bashkiak</i>	10
<i>SHTOJCA E</i>	12
TERMINOLOGJIA	15

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Rrjeti ekologjik dhe korridoret lidhëse (krijuar me ChatGPT, maj 2025).	4
Figura 2. Format pjesëmarrjes publike. Burimi: IDRA (2013) cituar Sh.Arnstein (1969)	14
Figura 3. Nivelet e pjesëmarrjes publike. Burimi: British Columbia University,2008.	15

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Metodat e pjesëmarrjes së qytetarëve. Burimi: OECD, përpunuar nga autori.	19
Tabela 2. Llojet e konsultimit publik	21
Tabela 3. Tipologjia e mekanizmave të monitorimit qytetar	25

LISTA E KUTIVE

Kutia 1. Rast studimor: Qasja në Informacion	20
Kutia 2. Hakathonet në France mbi tatimet dhe politikat fiskale	23
Kutia 3. Studim rasti: Shkenca qytetare – Plastic Pirates.....	24
Kutia 4. Takim i hapur për buxhetimin me pjesëmarrje në Korçë.....	27
Kutia 5. Asambleja Qytetare në Belgjikë	28
Kutia 6. Kutia e Praktikës së Mirë – Gjermania: “Green Belt” (Brezi i Gjellbër)	30

1. HYRJE

Zona Polis–Valamarë–Rungajë–Moravë–Gramoz, një territor me rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare për biodiversitetin, strukturat ekologjike dhe shërbimet e ekosistemit që ofron, shtrihet në tri qarqe (Elbasan, Berat, Korçë) dhe përfshin territorin e gjashtë bashkive: Librazhd, Prenjas, Gramsh, Skrapar, Maliq dhe Pogradec.¹ Brenda kësaj hapësire ndodhen gjashtë zona të mbrojtura të kategorive të ndryshme, përfshirë Parkun Kombëtar të Tomorrit dhe atë të Shebenikut, si dhe peizazhe të mbrojtura me vlera të larta ekologjike si Guri i Nikës–Valamarë, Liqeni i Pogradecit, Dardhë–Xhyrë, dhe zona të natyrës së veçantë si Stravaj–Sopot.² Të dhënat tregojnë se kjo zonë mbart një mozaik unik të ekosistemeve tokësore dhe ujore, habitatet e të cilëve përfaqësojnë më shumë se 30% të florës së Shqipërisë dhe janë shtëpi për specie të rralla, endemike dhe të rrezikuara.

Kjo zonë përbën një nyje të rëndësishme në rrjetin ekologjik kombëtar, duke funksionuar si një korridor i gjallë i lidhjes midis qendrave ekologjike që mundësojnë migrimin, ripopullimin dhe ndërveprimin gjenetik të specieve. Ajo përfshin territore që kanë një rëndësi të veçantë për mbijetesën e gjitarëve të mëdhenj si ariut të murrme, rrëqebullit të Ballkanit, kaprollit, si dhe një mori shpendësh, amfibësh dhe organizmash ujorë. Shumë prej këtyre specieve janë pjesë e listave të mbrojtura të IUCN, Konventës së Bernës dhe direktivave të BE-së për natyrën.

Megjithatë, zona përballlet me presione të shumta si rezultat i fragmentimit të habitatit, shpyllëzimit të paligjshëm, ndotjes, zhvillimeve infrastrukturore të pakontrolluara, mungesës së menaxhimit të qëndrueshëm të tokës, si dhe rrezikut në rritje nga ndikimet e ndryshimeve klimatike. Veprimtaritë e komuniteteve lokale, shpesh të varura nga përdorimi intensiv i burimeve natyrore, ndikojnë ndjeshëm në ekuilibrin ekologjik dhe cilësinë e shërbimeve të ekosistemit.

Përballë këtyre sfidave, angazhimi i komunitetit dhe aktorëve lokalë në procesin e vendimmarrjes është thelbësor. Pjesëmarrja publike nuk duhet të shihet vetëm si një detyrim ligjor, por si një mekanizëm transformues që mundëson qeverisje të mirë, rritje të përgjegjësisë kolektive dhe mbrojtje efektive të pasurive natyrore. Përfshirja e qytetarëve, fermerëve, të rinjve, grave dhe bizneseve lokale në proceset e planifikimit dhe zbatimit të masave për menaxhimin e korridoreve ekologjike është një kusht për qëndrueshmëri afatgjatë.

Ky udhëzues është hartuar për të ndihmuar bashkitë dhe aktorët lokalë në Shqipëri të planifikojnë, zhvillojnë dhe vlerësojnë procese të qëndrueshme të pjesëmarrjes publike në vendimmarrje, në veçanti në kontekstin e menaxhimit të integruar të korridoreve ekologjike në zonën juglindore të vendit. Ai fokusohet në zonën e njohur si CCA – *Connectivity Conservation Area* që përfshin segmentin Polis–Valamarë–Rungajë–Moravë–Gramoz, një territor me rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare për biodiversitetin, strukturat ekologjike dhe shërbimet e ekosistemit që ofron.³

1.1 Qëllimi dhe përdorimi i udhëzuesit

Objektivi kryesor i këtij dokumenti është të udhëzojë dhe mbështesë qeverisjen vendore, për të përgatitur, planifikuar, organizuar, kryer dhe raportuar procesin e pjesëmarrjes publike lidhur me korridorin ekologjik Polis–Valamarë–Rungajë–Moravë–Gramoz.

Udhëzuesi ka gjithashtu, për qëllim të rrisë qartësinë e procesit të konsultimit dhe pjesëmarrjes publike në përgjithësi për grupet e interesit, komunitetin vendor, biznesin dhe qytetarët, dhe t'i ndihmojë ata të kuptojnë se si planifikohen dhe zbatohen politikat vendore.

¹ Ibid, fq.25

² Ibid, fq.9-21

³ (Qirjo, 2024), f.2-6

Në një kohë kur presionet mjedisore po rriten, përfshirë ndikimet e ndryshimeve klimatike dhe zhvillimin e pakontrolluar të territorit, nevoja për një ndërveprim të strukturuar, të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës ndërmjet aktorëve lokalë dhe komuniteteve është më urgjente se kurrë. Përgjatë këtyre sfidave, pjesëmarrja e informuar e qytetarëve në vendimmarrje mbetet një shtyllë kyçe për ruajtjen e natyrës dhe mirëqenien e komuniteteve lokale.

Procesi i konsultimeve publike në Shqipëri rregullohet nga ligji nr.146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”. Në sektorë të caktuar konsultimi publik është i rregulluar shprehimisht në ligje të veçanta gjithashtu, si për shembull konsultimi në fushën e mjedisit, rregullohet nga ligji për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe ligji për vlerësimin strategjik mjedisor.

Ky udhëzues është i hartuar dhe mbështetur në bazë të kuadrit ligjor që rregullon pjesëmarrjen publike, konsultimin publik, si dhe praktikave më të mira në Shqipëri, dhe ofron modele dhe raste studimi për përmirësimin e cilësisë dhe zbatimit të konsultimit publik në vend.

Ky udhëzues synon të ofrojë një rrugë të qartë për përfshirjen e publikut në vendimmarrje, që nga identifikimi i çështjeve deri te marrja e përgjigjeve nga autoritetet përkatëse. Ai përfaqëson një instrument praktik dhe udhërrëfyes për të gjitha palët e interesuara – qytetarë, zyrtarë vendorë, këshilltarë bashkiakë, organizata të shoqërisë civile – për të ndërtuar një kulturë të re të bashkëpunimit publik në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm dhe mbrojtjes së natyrës. Duke u mbështetur në parimet e vetëqeverisjes, të drejtën për informacion dhe pjesëmarrje efektive, ky udhëzues kombinon përvojat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare për të lehtësuar zbatimin e të drejtave ekzistuese dhe për të dhënë zgjidhje konkrete ndaj sfidave që ndeshen në praktikë.

1.2 Pse pjesëmarrja publike në korridoret ekologjike është thelbësore

Korridoret ekologjike janë zona natyrore ose të ripërtëritura, që lidhin habitatet e ndryshme të florës dhe faunës në mënyrë që speciet të kenë mundësi të lëvizin, të riprodhohen dhe të ndërveprojnë mes tyre. Ato veprojnë si ura biologjike, duke lehtësuar migrimin e kafshëve dhe shkëmbimin gjenetik midis popullatave që ndodhen në territore të ndara. Këto korridore janë pjesë thelbësore e Rrjetit Evropian të Zonave të Mbrojtura NATURA 2000 dhe janë të përcaktuara në Ligjin Nr. 81/2017 "Për Zonat e Mbrojtura" të Republikës së Shqipërisë.

Sipas nenit 4 të këtij ligji, “Zona të mbrojtura” përfshijnë territore dhe ekosisteme me rëndësi për ruajtjen e biodiversitetit, ku korridoret ekologjike janë element kyç për lidhjen dhe funksionimin e qëndrueshëm të këtyre zonave.



FIGURA 1. RRJETI EKOLOGJIK DHE KORRIDORET LIDHËSE (KRIJUAR ME AI, MAJ 2025).

Pse janë të rëndësishme për komunitetin?

Korridoret ekologjike kanë rëndësi të madhe për komunitetin për arsye të ndryshme:

Ruajtja e biodiversitetit: Lëvizja e lirë e specieve ndihmon në ruajtjen e biodiversitetit dhe parandalon izolimin e popullatave, që është thelbësore për mbijetesën e specieve të rrezikuara. Ky aspekt është i përmendur edhe në Strategjinë Kombëtare për Biodiversitetin (2018-2030), ku mbrojtja e korridoreve ekologjike paraqitet si një nga prioritetet për ruajtjen e ekosistemeve natyrore.

Shërbimet ekosistemike për komunitetin: Korridoret ekologjike ndihmojnë në ruajtjen e shërbimeve natyrore që mbështesin jetën njerëzore, si pastrimi i ajrit dhe ujit, kontrolli natyral i përhapjes së sëmundjeve, stabilizimi i klimës lokale dhe ruajtja e tokës nga erozioni.

Zhvillimi i agroturizmit dhe turizmit natyror: Korridoret ekologjike ofrojnë mundësi për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm, përfshirë agroturizmin dhe turizmin ekologjik, duke krijuar mundësi të reja ekonomike për komunitetet lokale. Kjo është e përcaktuar edhe në Ligjin Nr. 80/2015 "Për Turizmin" dhe strategjitë rajonale për zhvillimin e turizmit, ku biodiversiteti dhe ruajtja e natyrës janë elementë të rëndësishëm për promovimin e destinacioneve turistike.

Përmirësimi i shëndetit publik: Ekosistemet e shëndetshme kontribuojnë në mirëqenien e njerëzve duke ofruar ajër të pastër, hapësira për rekreacion dhe uljen e stresit. Kjo përputhet me objektivat e Strategjisë Kombëtare të Shëndetit Publik, ku mjedisi natyror konsiderohet si një faktor kyç për shëndetin e popullatës.

1.3 Roli i aktorëve lokale dhe ndërveprimi i tyre

Pjesëmarrja publike në menaxhimin e korridoreve ekologjike kërkon angazhimin e një game të gjerë aktorësh. Çdo aktor ka një rol të veçantë në ndërtimin dhe funksionimin e mekanizmave demokratikë për vendimmarrje të qëndrueshme, me qëllim ruajtjen e biodiversitetit dhe zhvillimin lokal të integruar. Ky kapitull ofron një pasqyrë të rolit dhe përgjegjësisë të secilit grup aktorësh në territorin e zonës CCA.

Aktorët kyç në nivel lokal

a. Bashkitë (Librazhd, Prrenjas, Gramsh, Pogradec, Maliq dhe Skrapar):


Janë aktorë kyç në menaxhimin e territorit, duke pasur kompetenca për planifikimin hapësinor, administrimin e burimeve natyrore (pyje, kullota, ujëra) dhe miratimin e rregulloreve vendore për mbrojtjen e mjedisit. Bashkitë janë përgjegjëse për organizimin e konsultimeve publike dhe për forcimin e partneritetit me komunitetin.

b. Këshillat Bashkiakë:

Kanë funksione legjislative në nivel vendor dhe rol mbikëqyrës në lidhje me transparencën dhe përfshirjen e qytetarëve. Janë instanca vendimmarrëse që mundësojnë miratimin e politikave për mbrojtjen e korridoreve ekologjike dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

c. Administratat Rajonale të Zonave të Mbrojtura (AdZM):

Luajnë një rol teknik dhe menaxherial në mbrojtjen e biodiversitetit dhe funksionimin e zonave të mbrojtura që ndërthuren me korridoret ekologjike. Janë partnerë kyç për monitorimin, raportimin dhe ndërhyrjet për konservimin.



d. Komuniteti lokal dhe përdoruesit e burimeve:

Përfshijnë fermerë, grupe grash, të rinj, banorë të fshatrave dhe të qyteteve që preken nga politikat dhe vendimet për territorin dhe natyrën. Ata janë burim i rëndësishëm informacioni, kujdestarë të territorit dhe kontribuues në ruajtjen e ekosistemeve.

e. Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC):

Veprojnë si ura ndërmjet komunitetit dhe autoriteteve publike. Ato ofrojnë ekspertizë, lehtësojnë proceset e pjesëmarrjes, ndërgjegjësojnë publikun dhe monitorojnë zbatimin e angazhimeve për mjedisin dhe pjesëmarrjen qytetare.

f. Institucionet Arsimore dhe Akademike:

Universitetet dhe shkollat lokale mund të kontribuojnë në rritjen e ndërgjegjësimin, zhvillimin e studimeve mjedisore dhe në përgatitjen e brezave të rinj për angazhim aktiv në çështjet e territorit dhe natyrës.

h. Bizneset lokale dhe operatorët turistikë:

Përfshihen si partnerë potencialë në zhvillimin e ekoturizmit dhe ekonomisë së gjelbër, të bazuar në ruajtjen e pasurive natyrore. Bizneset që operojnë në zonën e korridorit ekologjik kanë ndikim të drejtpërdrejtë në mjedis dhe potencial për të kontribuar në mbrojtjen e tij.

i. Institucionet qendrore dhe Prefekturat:

Sigurojnë koordinimin ndërinstitucional dhe mbikëqyrjen ligjore të zbatimit të politikave dhe planeve në nivel lokal.

TABELA 1. LISTA E AKTORËVE KYÇ NË NIVEL VENDOR

Grupet e Aktorëve	Roli	Përgjegjësitë
Institucionet Qeveritare		
Hartuesit e Politikave dhe Rregullatorët	Hartojnë dhe zbatojnë ligje dhe politika për pjesëmarrjen publike. Sigurojnë përputhshmëri me kuadrin ligjor.	

	Ndajnë burime dhe mbështetje. Monitorojnë dhe vlerësojnë proceset e pjesëmarrjes publike.	
Agjencitë Mjedisore	Mbikëqyrin projektet mjedisore.	Sigurojnë informacion të qasshëm për publikun. Koordinojnë pjesëmarrjen publike. Përfshijnë kontributin publik në vendimmarrje.
Autoritetet Vendore		
Bashkitë	Zbatojnë projekte mjedisore lokale.	Organizojnë takime dhe konsultime publike. Angazhojnë komunitetin lokal. Marrin në konsideratë shqetësimet lokale në projekt.
Agjencitë Vendore (si RAPA)	Zbatojnë projekte mjedisore lokale.	Organizojnë takime dhe konsultime publike. Angazhojnë komunitetin lokal. Marrin në konsideratë shqetësimet lokale në projekt.
Organizatat Joqeveritare (OJQ)		
OJQ-të Mjedisore	Avokojnë për mbrojtjen e mjedisit.	Edukojnë dhe informojnë publikun. Organizojnë pjesëmarrjen e komunitetit. Ofron ekspertizë dhe mbështetje për angazhim publik.
Organizatat Bazuar në Komunitet (OBK)	Përfaqësojnë interesat lokale.	Lehtësojnë komunikimin mes komunitetit dhe autoriteteve. Ndihmojnë në mbledhjen e mendimeve të komunitetit. Avokojnë për nevojat e banorëve lokalë.
Anëtarët e Komunitetit		
Qytetarë dhe grupe me interesa të veçanta	Marrin pjesë në konsultime dhe vendimmarrje.	Qëndrojnë të informuar për projektet lokale. Japin komente dhe sugjerime. Bashkëpunojnë me aktorë të tjerë për ndikim pozitiv.
Liderë dhe përfaqësues të komunitetit	Udhëheqin përpjekjet për pjesëmarrje publike.	Përfaqësojnë interesat e komunitetit. Nxisin përfshirje të gjerë. Komunikojnë reagimet e komunitetit për t'u marrë parasysh.
Sektori Privat	Ofron ekspertizë dhe burime për zgjidhje të qëndrueshme.	Jep informacion për ndikimet e projekteve. Merr pjesë në konsultime dhe përfshin reagimet në zbatim. Zbaton masa zbutëse dhe monitorim të ndikimeve.

2. KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

Korniza ligjore për pjesëmarrjen publike në procesin e vendimmarrjes në nivelin lokal në Shqipëri përbëhet nga disa akte ligjore. E drejta për pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrjen në nivelin lokal, rregulluar nga aktet më të larta drejt akteve më nivel më të ulët normativ.

2.1 Legjislacioni Shqiptar për Mjedisin dhe Pjesëmarrjen Publike

Kushtetuta – themel për pjesëmarrje

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë⁴ ndonëse nuk përmend në mënyrë të drejtpërdrejtë pjesëmarrjen publike në vendimmarrje, garanton një sërë të drejtash që e mbështesin këtë të drejtë si pjesë e shtetit demokratik.

Edhe pse jo e përcaktuar në mënyrë të shkruar dhe shteruese e drejta e qytetarëve për pjesëmarrje dhe angazhim në vendimmarrje buron nga një sërë parimesh të shtetit demokratik të garantuara nga kushtetuta të tilla si: “*e drejta e referendumit*”, “*e drejta e lirisë së fjalës*” “*e drejta e informimit*” “*e drejta e grumbullimit*” “*e drejta e organizimit*” “*e drejta për të propozuar ligje*” “*Liria për akses në informacionin publik*” e *drejta për një mjedis të shëndetshëm* etj

Neni 23⁵ i Kushtetutës parashikon se e drejta e informimit është e garantuar. Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore.

Neni 48, i krijon publikut mundësinë për ti drejtuar kërkesa, ankesa si dhe vërejtje organeve publike dhe detyron njëkohësisht këto të fundit të kthejnë përgjigje në afatet dhe kushtet e caktuara me ligj.

Neni 56, i kushtetutës garanton të drejtën e informimit për çështjet lidhur me gjendjen e mjedisit dhe mbrojtjen e tij.

Kodi i Procedurave Administrative (Ligji nr.44/2015)

Kodi i Procedurave Administrative, është një ligj procedural i rëndësishëm, i cili parashikon

disa parime bazike procedurale, ndër të tjera dhe atë të pjesëmarrjes. Neni 1 i tij përvijon objektin e ligjit dhe vëren se “...Dispozitat e këtij Kodi zbatohen edhe mbi aktet normative për aq sa një gjë e tillë është e mundur”. Pra, shprehimisht Kodi nuk parashikon përjashtimin nga parimi i pjesëmarrjes për sa i përket procedimeve për nxjerrjen e akteve normative, akteve të planifikimit apo të programimit.

- **Parimi i transparencës (Neni 5)** – Institucionet publike duhet të punojnë hapur dhe të përfshijnë qytetarët.
- **E drejta për informacion (Neni 6)** – Çdo person mund të kërkojë informacion pa dhënë arsye.
- **Shërbime me “një ndalesë” (One-stop-shops)** – Zyrat publike kanë detyrimin të ofrojnë shërbime afër qytetarëve.

Ky kod u jep qytetarëve akses në dokumente dhe vendime administrative, dhe u kërkon institucioneve të punojnë në mënyrë të hapur dhe bashkëpunuese.

⁴ Ndryshuar me ligjin nr. 9675, datë 13.1.2007; Nr.9904, datë 21.4.2008; Nr. 88/2012, datë 18.9.2012, Nr. 137/2015, datë 17.12.2015 dhe Nr.76/2016, datë 22.7.2016

⁵ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Ligji për Vetëqeverisjen Vendore (Nr.139/2015)

Ligji i posaçëm që rregullon në mënyrë të detajuar të gjithë aspektet formale dhe materiale të organizimit dhe funksionimit të qeverisjes vendore është Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Pikërisht ky ligj trajton dhe rregullon edhe të drejtat e publikut gjatë vendimmarrjes së autoriteteve vendore, bashkitë dhe këshillat e tyre.

E drejta e konsultimit e përcaktuar në **nenin 16** detyron njësitë e vetëqeverisjes vendore të përmbushin të gjitha detyrimet që vijnë nga ligji për njoftimin dhe konsultimin publik.

Neni 17 dhe 18 e garanton më tej të drejtën e pjesëmarrjes qytetare duke përcaktuar që mbledhjet e këshillave janë të hapura gjithmonë dhe se seancat e këshillimit janë të detyrueshme në disa raste specifike siç është hartimi i buxhetit vendor.

Ndërkohë, **neni 19** i jep të drejtën qytetarëve për t’u përcjellë organeve vendore, kërkesa, ankesa dhe vërejtje, si një e drejtë demokratike e qytetarëve për të shprehur shqetësimet e tyre para organeve përkatëse të njësive të vetëqeverisjes vendore.

Neni 20 përcakton të drejtën e qytetarëve për të propozuar marrjen e vendimmarrjes përkatëse nëpërmjet iniciativës qytetare. Kjo e drejtë materializon në praktikë përfshirjen aktive të qytetarëve në vendimmarrjen publike dhe influencimin e kësaj vendimmarrje.

Pjesëmarrja qytetare në vendimmarrjen e vetëqeverisjes vendore gjen mbështetje dhe në parashikimet e ligjit për strukturat komunitare. **Strukturat komunitare** në frymën e këtij ligji janë këshilla komunitare të lagjeve, të ngritura në bazë të iniciativës qytetare të organizuara mbi baza vullnetare. Ndërlidhësi dhe këshilli komunitar mund të mbështesin funksionet qeverisëse të bashkisë në lagjen e tyre dhe mund të zbatojnë projekte në dobi dhe përfitim të komunitetit.

Ligji për të drejtën e informimit (Nr. 119/2014)

Një nga ligjet më kryesore në legjislacionin shqiptar që garanton të drejtën e informimit në lidhur informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritet publike, është ligji Nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, miratuar më 18.09.2014. Me miratimin e këtij ligji është shfuqizuar ligji i mëparshëm Nr.8503, datë 30.06.1999, “Për të drejtën e informimit për Dokumentet Zyrtare”, i cili rregullonte të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare. Rregullat e parashikuara në këtë ligj kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë. Ky ligj ka për qëllim edhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike

Neni 3 i ligjit në fjalë sanksionon të drejtën e informimit si një të drejtë, të cilën e gëzon çdo person për tu njohur me informacion publik nëpërmjet dokumentit original ose kopje të tij pa u detyruar të shpjegojë motivet. **Autoriteti publik** ka detyrimin ligjor në këtë aspekt të informojë kërkuuesin nëse ka ose jo në zotërim informacion e kërkuar dhe njëkohësisht informacionin e dhënë një personi nuk mund ti refuzohet asnjë personi tjetër që e kërkon atë me përjashtim të rastit kur informacioni përmban të dhëna personale të subjektit konfront neni 17 të këtij ligji.

Ligji për njoftimin dhe konsultimin publik (Nr. 146/2014)

Ky ligj rregullon procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik të projektligjeve, projekt dokumenteve strategjike qofshin këto kombëtare apo vendore, si dhe të politikave me interes të lartë publik.

Dispozitat e këtij ligji përcaktojnë rregullat procedurale që duhen zbatuar për të garantuar transparencën dhe pjesëmarrjen e publikut në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse nga organet publike duke synuar nxitjen e transparencës, të përgjeshmërisë dhe integritetit të autoriteteve publike

Në **nenin 5** të ligjit përcaktohet se procesi i njoftimit dhe i konsultimit publik kryhet sipas parimeve të transparencës gjatë procesit të njoftimit e të konsultimit publik me pjesëmarrje gjithëpërfshirëse jo diskriminuese, efektshmëria e procesit të vendimmarrjes në organet publike dhe përgjegjësia e organeve publike ndaj palëve të interesuara.

Neni 6 dhe 7 parashikojnë detyrimin e organeve publike për njoftim dhe konsultim publik, për të marrë masat e nevojshme për të krijuar mundësinë e qytetarëve dhe palëve të interesuara për pjesëmarrje në procesin e njoftimit dhe konsultimit publik duke publikuar në programin e transparencës⁶ planet vjetore të organeve publike dhe publikimin në regjistrin elektronik të projekt aktit të njoftimit dhe të të dhënave lidhur me konsultimin e projek akteve. Regjistri elektronik është një faqe zyrtare interneti e cila shërben si pikë qendrore konsultimi dhe nëpërmjet këtij regjistri sigurohet akses dhe ofrohet mundësia e komunikimit të të gjitha palëve të interesuara me organin publik.⁷ Organi publik pas publikimit të njoftimit në regjistrin elektronik mund të realizojë me palët e interesuara konsultime të drejtpërdrejta dhe takime publike.⁸

Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit (Nr. 10431/2011)

Ligji Nr. 10431/2011 për Mjedisin, me ndryshimet e mëvonshme, përcakton parimet dhe mekanizmat për mbrojtjen e mjedisit dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore. Bashkitë janë përgjegjëse për organizimin dhe monitorimin e konsultimeve publike lidhur me projektet që mund të ndikojnë në mjedis, duke siguruar informim paraprak (neni 32) të komunitetit dhe mundësi për shprehjen e mendimeve përmes procesit të vlerësimit të ndikimit mjedisor (VVM). Ligji thekson nevojën që informacioni të jetë i qasshëm dhe i kuptueshëm për të gjitha grupet e interesit, dhe konsultimet publike janë pjesë e domosdoshme të procedurave administrative për miratimin e lejeve mjedisore. Sanksionon të drejtën për **informacion mjedisor dhe pjesëmarrje të publikut** në hartimin e politikave, planeve e programeve për mjedisin. Përfshin detyrimin për konsultim publik në proceset e vlerësimit strategjik mjedisor (VSM)⁹ dhe vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM).¹⁰

Ligji për Zonat e Mbrojtura (Nr. 81/2017 i ndryshuar me Ligjin nr.21/2024)

Ligji Nr. 81/2017 për Zonat e Mbrojtura përcakton krijimin, menaxhimin dhe mbrojtjen e zonave të mbrojtura në Shqipëri. Në këtë kuadër, bashkitë luajnë një rol të rëndësishëm në organizimin dhe mbikëqyrjen e procesit të konsultimit publik gjatë hartimit të planeve menaxhuese. Sipas nenit 17, ligji kërkon që bashkitë të përfshijnë komunitetet lokale dhe të zhvillojnë seanca publike për të siguruar transparencë dhe për të mbledhur opinione

⁶ Sipas ligjit nr 119/2014 “Për të drejtën e informimit”

⁷ Neni 8 i ligjit 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” përcakton se palët e interesuara në procesin e njoftimit dhe konsultimit publik janë: Organet publike, Shtetasit e Republikës së Shqipërisë dhe grupet e interesit, Personat fizikë të huaj me vendqëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë

⁸ Takim publik sipas ligjit 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” do të kuptojmë çdo takim të hapur me palët e interesuara për diskutimin e projektakteve që i nënshtrohen procesit të njoftimit dhe konsultimit publik me qëllim sqarimin dhe informimin e publikut në lidhje me këto projekta si dhe marrjen e komenteve e të rekomandimeve përkatëse për përmirsimin e tyre

⁹ Ligji nr. 10440/2011 “Për vlerësimin strategjik mjedisor”

¹⁰ Ligji nr. 10448/2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis

lidhur me kufijtë dhe rregullat që zbatohen në zonat e mbrojtura. Pjesëmarrja aktive e palëve të interesuara lokale është e domosdoshme për mbështetjen dhe zbatimin efektiv të masave mbrojtëse.

Ligji për Planifikimin e Territorit (Nr. 107/2014)

Ligji Nr. 107/2014 për Planifikimin e Territorit përcakton rregullat për planifikimin territorial në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor. Bashkitë kanë përgjegjësinë për organizimin e konsultimeve publike gjatë hartimit të planeve territoriale dhe urbanistike, siç përcaktohet në nenet 11 dhe 25 të ligjit. Këto nene kërkojnë publikimin e draft-planeve dhe duke njoftuar publikun për takimet konsultative. Konsultimet duhet të zhvillohen në të gjitha fazat e procesit, duke përfshirë komunitetin, organizatat lokale dhe palët e interesuara, dhe sugjerimet e pranuar duhet të dokumentohen dhe të merren në konsideratë gjatë miratimit përfundimtar të planeve. Ky ligj thekson rëndësinë e pjesëmarrjes qytetare dhe transparencës në vendimmarrje për zhvillimin territorial.

2.2 Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj

Konventa mbi të drejtën e Publikut për të Pasur Informacion për të marrë Pjesë në Vendimmarrje dhe për t'ju drejtuar Gjykatës për Çështjet e mjedisit. (Konventa Unece) ose (Konventa e Arhusit).

Konventa e UNECE, mbi të drejtën e publikut për të pasur informacion dhe për të marrë

pjesë në vendimmarrje dhe për tju drejtuar Gjykatës për çështjet e mjedisit, e ashtuquajtur ndryshe dhe konventa e Arhusit, nënshkruar më 25 Qershor 1998 në qytetin e Arhusit, Danimarkë, hyrë në fuqi më 30 Tetor 2001. Republika e Shqipërisë ka aderuar këtë konventë me Ligjin Nr. 8672 , datë 26.10.2000 “ Për Ratifikim e Konventës së Arhusit, për të drejtën e publikut, për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për tju drejtuar Gjykatës për çështjet e mjedisit”.

Në përmbajtjen e saj, Konventa rregullon tri fusha kryesore:¹¹

Konteksti	Angazhimet	Institucionet	Pajtueshmëria
Objektivat (Preambula) Përkufizimet (Neni 2)	Aksesi në Informacion (Neni 4) Pjesëmarrja Publike (Neni 5) Aksesi në Drejtësi (Neni 9)	Konferenca e Palëve Sekretariati Task Forcat Komiteti i Konventës për Pajtueshmërinë Autoritete Kombëtare	Komunikimi Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve (Neni 16)

- a) Të drejtën e secilit që të marrë informata mjedisore që mbahen nga autoritetet publike. Kjo përfshin informacionet mbi gjendjen e mjedisit, por edhe politikat dhe masat e ndërmarra, ose gjendjen e shëndetit të njerëzve dhe sigurinë kur ajo mund të ndikohet nga gjendja e mjedisit. Qytetarëve iu garantohet që mund të marrin informacionin e kërkuar brenda një muaji pas paraqitjes së kërkesës, pa qenë të detyruar t'i japin arsytet se pse e kërkojnë atë informacion. Për më tepër, autoritetet publike, sipas Konventës, janë të përgjegjshëm të ofrojnë qytetarëve informacionin mjedisor me të cilin disponojnë (“qasja në informacionin mjedisor”);

¹¹ Konventa e Aarhusit, qytetarin e thjeshtë, nga një bartës detyrimesh e bën një partner aktiv në vendimmarrjen për çështjet mjedisore duke ia siguruar atij kështu: të drejtën për të qenë i informuar për situatën mjedisore ku jeton, të drejtën jo vetëm për të marrë pjesë aktive në vendimmarrje për çështje mjedisore, por të ketë edhe të drejtën e qasjes në mbrojtjen ligjore në rast të shkeljes të së drejtës së tij për një mjedis të pastër Si akt normativ me karakter ndërkombëtar, Konventa e Aarhus-it vendos një numër të drejtash për publikun në lidhje me mjedisin. Autoritetet publike (në nivel kombëtar, rajonal ose lokal) duhet të kontribuojnë që këto të drejta të mos mbeten vetëm në rrafshin teorik por të bëhen efektive duke u zbatuar në praktikë.

<https://unece.org/environment-policy/public-participation/aarhus-convention/introduction>

- b) Të drejtën për të marrë pjesë në fazat e nismës të procesit të vendimmarrjes për mjedisin. Autoritetet duhet t'i bëjnë të gjitha veprimet e duhura për t'ju mundësuar qytetarëve dhe organizatave mjedisore të ofrojnë komente dhe propozime përkitazi me projektet që trajtojnë mjedisin, planet dhe programet mjedisore, dhe ato komente të merren në konsideratë gjatë procesit të vendimmarrjes ("pjesëmarrja e publikut në vendimmarrjen mjedisore");
- c) Të drejtën e individit t'i drejtohet gjykatave për shkeljen e së drejtës së tij për qasje në informacione mjedisore apo lidhur me vendimet publike që janë marrë pa u respektuar e drejta e pjesëmarrjes publike përcaktuar me nenin 6 të Konventës ("qasja në drejtësi")

Karta Evropiane e Vetëqeverisjes Vendore

Karta Evropiane për Vetëqeverisjen Vendore, hartuar nga një grup ekspertësh qeveritarë, nën drejtimin e Komitetit Drejtues për Çështjet Rajonale dhe Bashkiake, u hap për nënshkrim si konventë për shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, më 15 tetor 1985. Republika e Shqipërisë, ka aderuar në këtë konventë me Ligjin Nr. 8548 datë 11.11.1999 "Për Ratifikimin e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore".

Teksti i kësaj konvente synon aderimin e organeve, veprimet e të cilave janë shumë të rëndësishme në çdo mbrojtje të autonomisë vendore, pra aderimin e qeverive. Qëllimi i Kartës është të plotësojë mungesën e standarteve të përbashkëta evropiane për matjen dhe garantimin e të drejtave të organeve vendore, të cilat janë më pranë qytetarëve, dhe t'i japë qytetarëve mundësinë e pjesëmarrjes efektive në marrjen e vendimeve që kanë ndikim mbi përditshmërinë e tyre.

Karta evropiane për vetqeverisje vendore është traktati i parë ndërkombëtar obligues që garanton të drejtat e komuniteteve dhe të autoriteteve të tyre të zgjedhura, si dhe që përcakton parimin e subsidiaritetit sipas të cilit ushtrimi i përgjegjësisë publike duhet, në mënyrë të përgjithshme, t'i takojë më tepër autoriteteve më të afërta të qytetarëve. Përmes nënshkrimit të Kartës Evropiane, shtetet zotohen të respektojnë parimet bazë, në mes të tjerash, të drejtën e qytetarëve që të marrin pjesë në menaxhimin e çështjeve publike.

2.3 Roli i Bashkive dhe NJQV dhe strukturave mbështetëse

Bashkitë në Shqipëri luajnë një rol themelor në garantimin e pjesëmarrjes publike në proceset vendimmarrëse, sidomos në fushat që lidhen me mjedisin, zhvillimin e territorit dhe përdorimin e burimeve natyrore. Ky rol është i përcaktuar në mënyrë të qartë në kuadrin ligjor shqiptar, ku Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, i njeh bashkive përgjegjësi të drejtpërdrejta për të promovuar transparencën dhe përfshirjen qytetare në qeverisjen vendore. **Neni 16** i këtij ligji përcakton se bashkitë kanë detyrimin të garantojnë të drejtën e publikut për të marrë pjesë në vendimmarrje përmes konsultimeve të hapura, takimeve publike dhe formave të tjera të përfshirjes aktive.

Ligji "Për njoftimin dhe konsultimin publik" (nr. 146/2014) i përforcon këto përgjegjësi duke vendosur detyrimin që çdo organ publik, përfshirë bashkitë, të njoftojë publikun dhe të zhvillojë konsultime për draft-akte të rëndësishme, si planet e përgjithshme vendore, politikat mjedisore, programet e investimeve dhe rregulloret që prekin komunitetin. Ky ligj parashikon afate minimale për publikimin e dokumenteve për koment, mënyra për dorëzimin e sugjerimeve dhe përgjegjësinë e autoritetit publik për të reflektuar apo adresuar këto sugjerime.

Përveç kësaj, Ligji nr. 81/2017 "Për zonat e mbrojtura" parashikon se çdo ndryshim në planet e menaxhimit të zonave të mbrojtura apo ndonjë ndërhyrje në territor që ndikon në biodiversitetin lokal duhet të paraprihet nga një proces konsultimi publik të mirëstrukturuar. Ligji kërkon që autoritetet vendore të punojnë ngushtë me administratat rajonale të zonave të mbrojtura dhe komunitetet për të garantuar që vendimet të jenë gjithëpërfshirëse dhe të bazuara në interesin publik.

Në këtë kuadër, bashkitë nuk janë vetëm ekzekutues të politikave por edhe garantues të një qeverisjeje gjithëpërfshirëse dhe transparente. Ato duhet të krijojnë mekanizma të qartë për konsultime efektive, si platforma online për konsultim, njoftime në faqet zyrtare dhe në media lokale, mbajtjen e dëgjësave publike, takimeve në komunitet dhe bashkëpunimit të strukturuar me organizatat e shoqërisë civile. Mospërmbyshja e këtyre detyrimeve jo vetëm që përbën shkelje të ligjit, por edhe minon legjitimitetin e vendimmarrjes lokale dhe mund të përshpejtojë konfliktet sociale apo dëmtimin

Përmes një qasjeje proaktive dhe të strukturuar, bashkitë mund të kthehen në modele të qeverisjes së mirë lokale, duke forcuar besimin e qytetarëve dhe duke kontribuar në ruajtjen e natyrës dhe zhvillimin e qëndrueshëm të komuniteteve.

Çfarë mund të bëjë qytetari? Dhe çfarë thotë ligji?

E drejta/pjesëmarrja	Ku garantohet? (ligji)	Përshkrim i shkurtër
Të informohesh për aktivitetin e institucioneve	Kushtetuta, neni 23; Ligji 119/2014	Të drejtë për akses në dokumente publike, pa shpjeguar motive
Të kërkohsh, ankohesh ose të japësh sugjerime	Kushtetuta, neni 48 dhe 56; Ligji 139/2015, neni 19	Mund të drejtohesh me kërkesa dhe vërejtje që duhen shqyrtuar
Të marrësh pjesë në konsultime	Ligji 146/2014; Ligji 139/2015, nenet 16-18	Organet publike janë të detyruara të njoftojnë dhe të dëgjojnë qytetarët
Të ndjekësh mbledhjet publike të këshillit	Ligji 139/2015, neni 17	Mbledhjet e këshillave bashkiakë janë të hapura për publikun
Të marrësh pjesë në hartimin e buxhetit vendor	Ligji 139/2015, neni 18	Bashkitë duhet të konsultohen me komunitetin për buxhetin
Të nismosh një vendimarrje	Ligji 139/2015, neni 20	Qytetarët mund të nisin vetë një vendim me mbështetje qytetare
Të kërkohsh informacion pa ndonjë arsye të veçantë	Ligji 119/2014	Autoriteti është i detyruar të përgjigjet, përveç në raste specifike
Të kërkohsh transparencë gjatë çdo vendimarrjeje	Kodi i Procedurave Administrative	Parimet e transparencës dhe informimit janë të detyrueshme
Të mbështetesh te këshillat komunitare	Ligji 139/2015	Strukturat komunitare veprojnë si ura lidhëse me bashkinë

3. FORMAT DHE MEKANIZMAT E PJESËMARRJES PUBLIKE

Ky kapitull paraqet një qasje të strukturuar për organizimin e një procesi të mirëfilltë të pjesëmarrjes publike në nivel vendor, me theks të veçantë në kontekstin e menaxhimit të korridoreve ekologjike. Ai përshkruan hapat kryesorë që duhet të ndjekin bashkitë dhe aktorët lokalë, nga identifikimi i palëve të interesuara deri te integrimi i komenteve në vendimarrje dhe vlerësimi i ndikimit të procesit. Proces i propozuar synon të sigurojë një përfshirje gjithëpërfshirëse, transparente dhe të qëndrueshme të komuniteteve dhe grupeve të interesit në politikën dhe praktikën që lidhen me ruajtjen e natyrës dhe zhvillimin e qëndrueshëm të territorit.

3.1 Llojet dhe nivelet e pjesëmarrjes publike

Pjesëmarrja publike është përfshirja e qytetarëve në funksionet administrative dhe vendimmarrëse, e cila është arritur me disponueshmërinë e mekanizmave të ndryshme në fusha të ndryshme funksionale dhe përmes pjesëmarrjes në procesin e vendimmarrjes. Mekanizmat për pjesëmarrje përfshijnë; dëgjesa publike, borde këshillimore qytetare, focus grupe me qytetarët, takime me bizneset, dhe mbledhje.¹²

Sipas OKB-së (United Nations, 2013) pjesëmarrja qytetare nënkupton angazhimin aktiv të qytetarëve në vendimmarrje, me qëllim që programet qeveritare të orientohen më mirë drejt nevojave të komunitetit, të forcohet mbështetja publike dhe të ndërtohet një ndjenjë bashkësie. Në këtë kuadër, përfshirja e qytetarëve në administratën publike nënkupton krijimin e mundësive për të marrë pjesë në vendimmarrjen shtetërore përmes mekanizmave dhe strukturave institucionale që synojnë rritjen e ndikimit të tyre në politikat dhe programet publike, duke ndikuar pozitivisht në mirëqenien e tyre sociale dhe ekonomike.¹³




FIGURA 2. FORMAT PJESËMARRJES PUBLIKE. BURIMI: IDRA (2013) CITUAR SH.ARNSTEIN (1969)

Me qëllim pasqyrimin e thjeshtëzuar të shkallës së pjesëmarrjes qytetare, Sh. Arnstein (Sh. Arnstein, 1969) zhvilloi një shkallë me tetë nivele për të shpjeguar format e ndryshme të pjesëmarrjes qytetare.

Në këtë mënyrë, manipulimi dhe 'terapia' kolektive qëndrojnë në fund të shkallës. Këto kategori përfaqësojnë nivelin e mospjesëmarrjes ose të qytetarisë pasive. Më tej, informimi,

konsultimi dhe pjesëmarrja simbolike përshkruajnë nivelin ku qytetarët mundën me të vërtetë që të dëgjohen por ata nuk kanë fuqinë për të siguruar se pikëpamjet e tyre do të merren në konsideratë. E thënë ndryshe, këto tre kategori shërbejnë për të krijuar imazhin e një qytetarie aktive. Në shkallët më të larta renditen bashkëqeverisja, vendimarrja qytetare dhe kontrolli qytetar, shkallë në të cilat qytetarët kanë një ndikim të lartë në vendimmarrje ose fuqi të plotë vendimmarrëse.¹⁴

¹² L. Carson (2008). The IAP2 Spectrum; http://www.actedemocracy.net/articles/Journal_08December_Carson.pdf

¹³ OKB, 'Citizen Engagement and the Post-2015 Development Agenda: Report of the Expert Group Meeting', 2013, http://eorkspace.unpan.org/sites/Internet/Documents/EGM%20Report-Beirut-3-4Dec-2012_FINAL_cleared%20on%2008-07-2013.pdf

¹⁴ Sh. R. Arnstein (1969), 'A Ladder of Citizen Participation', Journal of the American Institute of Planners 35.4: 216–224, http://lithgow-schmidt.dk/sherry-arnstein/ladder-of-citizenparticipation_en.pdf

Pas modelit të Arnstein-it, janë zhvilluar edhe studime të tjera mbi pjesëmarrjen qytetare, ndër të cilat spikat ai i provincës British Columbia (British Columbia, 2008) që e ndan pjesëmarrjen në pesë nivele, e treguar në Figurën 3.¹⁵

- **Niveli i parë**, që përfaqëson edhe shkallën më të ulët të përfshirjes, ka të bëjë me informimin dhe edukimin e publikut, pa përfshirje të drejtpërdrejtë në vendimarrje.
- **Niveli i dytë** fokusohet në mbledhjen e informacionit, përmes dëgjësive publike dhe pranimit të shqetësimeve të qytetarëve.
- **Niveli i tretë**, që përfaqëson një pjesëmarrje të ndërmjetme, përfshin diskutimin dhe shkëmbimin aktiv të ideve, ku qytetarët punojnë së bashku me institucionet për të identifikuar çështjet dhe prioritetet.
- **Niveli i katërt** ka të bëjë me angazhimin më të thellë të qytetarëve, përmes kërkimit të këshillave, ideve dhe zgjidhjeve inovative nga ana e tyre.
- **Niveli i pestë**, që është edhe më i avancuari, përfshin partneritetin me publikun, ku qytetarët marrin pjesë në mënyrë të barabartë në vendimarrje dhe në zbatimin e politikave apo projekteve të përbashkëta.




FIGURA 3. NIVELET E PJESËMARRJES PUBLIKE. BURIMI: BRITISH COLUMBIA UNIVERSITY, 2008.

Ndërsa, OECD-ja ofron një klasifikim më gjithëpërfshirës të pjesëmarrjes qytetare duke i'u referuar natyrës dhe drejtimit të marrëdhënies midis qeverisë dhe qytetarëve si në vijim:¹⁶

- Informimi – një marrëdhënie me një drejtim sipas së cilës qeveria vetëm prodhon dhe ofron informacion për qytetarët e saj.
- Konsultimi – një marrëdhënie me dy drejtime në të cilën qytetarët mund ti sigurojnë 'feedback' qeverisë duke kontribuar me këndvështrimet dhe opinionet e tyre.
- Pjesëmarrja aktive – një marrëdhënie e bazuar te bashkëqeverisja, në të cilën qytetarët angazhohen në procesin e vendimarrjes.

Koncepti i konventave mjedisore për **pjesëmarrjen publike** bazohet në parimin se qytetarët kanë të drejtë të informohen, të marrin pjesë në proceset vendimmarrëse dhe të kenë akses në drejtësi për çështje që lidhen me mjedisin. Këto konventa synojnë të forcojnë transparencën, përgjegjshmërinë dhe përfshirjen e publikut në mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Konventa e Espoos (1991): E miratuar nga Komisioni Ekonomik për Evropën i OKB-së (UNECE), kjo konventë garanton përfshirjen e publikut në proceset e vlerësimit të ndikimit mjedisor, sidomos kur aktivitetet kanë pasoja ndërkufitare.

¹⁵ British Columbia, 2008, <https://www.bcauditor.com/sites/default/files/publications/2008/report11/report/public-participation-principles-and-best-practices-british-columbia.pdf>

¹⁶ OECD, 'Citizens as Partners: Information, Consultation and Public Participation in Policy-Making', 2001, http://www.ecnl.org/dindocuments/214_OECD_Engaging%20Citizens%20in%20Policy-Making.pdf

Deklarata e Rio-s për Mjedisin dhe Zhvillimin (1992): Përmes Parimit 10, thekson të drejtën e qytetarëve për informacion, pjesëmarrje dhe akses në drejtësi për çështjet mjedisore.

Konventa e Aarhus-it (1998): E konsideruar si instrumenti më i plotë ligjor për pjesëmarrjen publike në çështjet mjedisore, kjo konventë parashikon tre shtylla themelore: akses në informacion, pjesëmarrje në vendimmarrje dhe akses në drejtësi.

Ka shumë metoda dhe teknika që mund të përdoren për realizimin e konsultimit publik. Çdo metodë ka avatazhet dhe disavantazhet e saj. Asnjë prej tyre nuk mund të sigurojë efektivitetin maksimal për çdo diskutim publik në çdo iniciativë dhe vendimmarrje. Kombinimi i disa metodave është mundësia më e mirë për të arritur rezultatin e dëshiruar.

Nuk ka një metodë të vetme që do të mund të rekomandohej për konsultimin publik, sikurse nuk ka një çështje të caktuar për të cilën mund të përdoret një metodë e vetme konsultimi. Përcaktimi se cila metodë do të ishte më efektive në një diskutim të caktuar vendimmarrje, është një sfidë për drejtuesit e bashkisë.

3.2 Procesi i pjesëmarrjes publike në menaxhimin e korridoreve ekologjike Polis–Valamarë–Rungajë–Moravë–Gramoz.

a. Përcaktimi i qëllimeve dhe fushës së pjesëmarrjes publike në proces.

Qëllimi kryesor i pjesëmarrjes publike në këtë zonë është ndërtimi i një konsensusi të gjerë për ruajtjen dhe menaxhimin e korridoreve ekologjike ndërmjet zonave të mbrojtura dhe komuniteteve që jetojnë përreth tyre. Pjesëmarrja synon mbledhjen e njohurive vendore, identifikimin e prioriteteve ekologjike dhe sociale, ndarjen e përgjegjësisë, dhe përfshirjen në vendimmarrje për masa konkrete si restaurimi i habitateve, lidhshmëria ekologjike dhe përdorimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore.

Shembull: Gjatë hartimit të një plani për rivendosjen e një zone kalimi për kafshët e egra ndërmjet Valamarës dhe Rungajës, komuniteti lokal informohet që sugjerimet dhe shqetësimet e tyre do të ndikojnë drejtpërdrejt në zgjedhjen e vendndodhjes dhe llojet e ndërhyrjeve.

b. Identifikimi i publikut dhe palëve të interesuara

Palët e interesuara në këtë proces përfshijnë institucionet shtetërore për menaxhimin e natyrës (AKZM, RAPA Korçë dhe Elbasan), bashkitë Librazhd, Kolonjë, Maliq dhe Pogradec, komunitetet e fshatrave që ndodhen në kufi me zonat e mbrojtura, organizatat lokale të fermerëve, grupet e grave dhe të rinjve, OJF-të mjedisore, guidat dhe operatorët turistikë, si dhe përfaqësues të sektorit privat me ndikim në territor (pylltari, bujqësi, energji, ndërtim).

Shembull: Për vendosjen e një zonë tampon midis pyjeve natyrore dhe sipërfaqeve të shfrytëzuara për kullotë, identifikohen si palë të interesuara blegtorët vendas, punonjësit e pyjeve dhe përfaqësuesit e zonave të mbrojtura.

c. Sigurimi që publiku të jetë i informuar objektivisht dhe në mënyrë të plotë

Informacioni për rëndësinë e korridoreve ekologjike, përfitimet nga lidhshmëria biologjike, ndikimet nga fragmentarizimi i habitatit, si dhe për projektet që do të zbatohen, duhet të shpërndahet në mënyrë të qartë dhe të përshtatur për çdo grup. Përdorimi i hartave vizuale, dokumentarëve të shkurtër dhe takimeve informuese në qendrat komunitare është thelbësor.

Shembull: Organizimi i një ekspozite fotografike në qendrën kulturore të Librazhdit për të treguar rëndësinë e lidhjes natyrore ndërmjet Polis dhe Moravës për jetën e kafshëve të egra.

d. Planifikimi i metodave dhe mjeteve për pjesëmarrjen publike

Hartoni një plan të detajuar me metodat, mjetet dhe afatet kohore për pjesëmarrje. Organizoni mbledhje dhe uorkshope për të informuar, dëgjuar dhe mbledhur komente, duke përdorur teknika ndërvepruese si diskutime në grupe të vogla, sesione pyetje-përgjigje dhe brainstorming. Përgatisni sondazhe dhe pyetësorë për të mbledhur të dhëna sasiore dhe cilësore. Përdorni forume online, uebinare dhe rrjete sociale për të angazhuar ata që nuk mund të marrin pjesë fizikisht.

Shembull: Në Kolonjë organizohet një punëtori me gratë fermere për të diskutuar mundësinë e përfshirjes së tyre në aktivitete për restaurimin ekologjik dhe ruajtjen e pyjeve.

e. Sigurimi i burimeve të nevojshme dhe përcaktimi i një afati kohor për aktivitetet

Zbatimi i pjesëmarrjes kërkon burime për organizimin e takimeve në zonat malore, për përkthimin e materialeve, për angazhimin e ekspertëve lokalë, si dhe për sigurimin e logjistikës. Duhet hartuar një kalendar që merr parasysh sezonet blegtorale dhe bujqësore që ndikojnë në angazhimin e komunitetit.

Shembull: Përdorimi i një furgoni të pajisur për komunikim vizual dhe prezantime lëvizëse në fshatra të zonës Polis–Valamarë për të informuar komunitetet që nuk kanë qasje të lehtë në internet.

f. Zbatimi i aktiviteteve dhe lehtësimi i dialogut

Organizoni aktivitetet në kohë dhe vende të përshtatshme për pjesëmarrësit, duke ofruar përkthim kur është e nevojshme dhe trajnime për të kuptuar çështjet. Sigurohuni që lehtësuesit e takimeve janë të trajnuar për të mbështetur një diskutim konstruktiv dhe gjithëpërfshirës.

Shembull: Në fshatin Dardhë organizohet një takim në ambientet e shkollës për të diskutuar ndikimin e zhvillimeve turistike në fragmentarizimin e habitatit pyjor.

g. Marrja e komenteve dhe analizimi i sugjerimeve

Të gjitha komentet, shqetësimet dhe propozimet e komunitetit duhet të dokumentohen, kategorizohen dhe analizohen. Duhet të tregohet qartë se si këto kontribuojnë në rishikimin e planit të menaxhimit ose hartimin e masave konkrete për ruajtjen e korridoreve.

Shembull: Pas konsultimit me komunitetin në Valamarë, përfshihet një masë për ndalimin sezonal të qarkullimit me mjete motorike në një shteg të rëndësishëm për kalimin e kafshëve të egra.

h. Informimi i vendimmarrësve dhe komunikimi i rezultateve me pjesëmarrësit

Duhet hartuar një raport përmbljedhës me të gjitha kontributet publike, metodologjinë e mbledhjes së tyre dhe ndikimin që kanë pasur në planin final. Ky raport të ndahet me institucionet vendimmarrëse, si dhe me publikun nëpërmjet mbledhjeve rikthyese dhe platformave online.

Shembull: Në faqen e bashkisë Kolonjë publikohet raporti i konsultimeve për korridorin ekologjik Moravë–Gramoz, i cili përfshin analizën e pjesëmarrjes dhe përmirësimet e planit bazuar në komente.

i. Vlerësimi i efektivitetit të procesit të pjesëmarrjes publike dhe rekomandimet për punën e ardhshme

Përcaktoni kritere për vlerësim si numri i pjesëmarrësve, diversiteti i përfaqësimit, cilësia e komenteve. Kryeni rishikime periodike, mbledhni komente mbi vetë procesin dhe publikoni raporte mbi vendimet e marra dhe ndikimin e pjesëmarrjes publike në to.

Shembull: Në fund të procesit, organizohet një sondazh në komunitetet përgjatë korridorit për të vlerësuar nëse pjesëmarrja e tyre ka ndikuar realisht në planifikim dhe në ndërtimin e bashkëpunimit afatgjatë me institucionet.

Konsultimet me aktorët lokalë tregojnë se një nga problematikat më të shpeshta është zhvillimi i konsultimeve në faza të vona të projekteve, kur vendimmarrja është në thelb e përfunduar. Një qasje e tillë kufizon mundësinë e reagimit real të publikut dhe cenon besueshmërinë e procesit. Për këtë arsye, rekomandohet që konsultimet publike të planifikohen dhe të zhvillohen që në fazat e hershme të konceptimit të projekteve, politikave apo planeve, përpara marrjes së vendimeve përfundimtare.

Kutia 7. Gabime të shpeshta në proceset e konsultimit publik

- Përzgjedhja paraprake e pjesëmarrësve vetëm nga aktorë që mbështesin projektin;
- Zhvillimi i konsultimeve si procedurë formale, pa reflektim real të komenteve;
- Njoftimi i konsultimeve vetëm përmes rrjeteve sociale, pa përdorur kanale të tjera informimi;
- Mungesa e transparencës mbi mënyrën se si sugjerimet e publikut merren ose jo parasysh.

4. MJETET PRAKTIKE TË PJESËMARRJES PUBLIKE

Ka shumë metoda dhe teknika që mund të përdoren për realizimin e konsultimit publik. Çdo metodë ka avantazhet dhe disavantazhet e saj. Asnjë prej tyre nuk mund të sigurojë efektivitetin maksimal për çdo diskutim publik në çdo iniciativë dhe vendimarrje. Kombinimi i disa metodave është mundësia më e mirë për të arritur rezultatin e dëshiruar. Nuk ka një metodë të vetme që do të mund të rekomandohej për konsultimin publik, sikurse nuk ka një çështje të caktuar për të cilën mund të përdoret një metodë e vetme konsultimi. Përcaktimi se cila metodë do të ishte më efektive në një diskutim të caktuar vendimarrje, është një sfidë për drejtuesit e bashkisë.

Në vijim renditen metodat që përdoren më shumë dhe që konsiderohen më efektive në konsultimin dhe angazhimin publik, bazuar në përvojat më të mira të bashkive me traditë në konsultimin publik dhe që kanë mundur të angazhojnë publikun e gjerë dhe ta motivojnë atë për të qenë aktiv dhe pjesë organike të vendimarrjes lokale.

TABELA 2. METODAT E PJESËMARRJES SË QYTETARËVE. BURIMI: OECD, PËRPUNUAR NGA AUTORI.

Metoda e pjesëmarrjes	Kur të përdoret	Konsiderata	Lloji i kontributit	Faza e procesit vendimarrës
Qasja në informacion dhe të dhëna	Kur kërkon mënyra për të rritur ndërgjegjësimin për një çështje ose vendim publik, dhe për të mbajtur publikun të informuar.	Është minimumi që mund të bëhet. Duhet përdorur kur nuk ka hapësirë për të dëgjuar qytetarët. Promovon transparencën dhe krijon kushte për metoda më të avancuara të pjesëmarrjes.	Ndërgjegjësim, transparencë, informacion i nevojshëm.	Identifikim, Formulim, Marrje vendimi, Zbatim, Vlerësim
Takime të hapura / Takime publike	Kur kërkon të informoni publikun dhe të merrni reagime fillestare të gjera.	Lejon shkëmbim mes autoriteteve publike dhe qytetarëve. Nuk jep gjykim përfaqësues ose zgjidhje të mirëinformuara.	Shkëmbim informacioni dhe reagime të gjera.	Identifikim, Formulim, Marrje vendimi, Zbatim, Vlerësim
Konsultim publik	Kur kërkon opinione të përmbledhura nga publiku për një debat politik ose çështje specifike.	Nuk është përfaqësues statistikor i popullsisë. Kërkon metodologji të përshtatur. Mund të jetë e vështirë për t'u përpunuar.	Preferenca individuale ose grupore, opinione, ide.	Identifikim, Formulim, Marrje vendimi
Inovacion i hapur: Crowdsourcing, Hackathon, Sfida publike	Kur kërkon zgjidhje kolektive për probleme specifike publike.	Kërkon kushte dhe burime të caktuara. Zakonisht kërkon ekspertizë nga pjesëmarrësit.	Ide kolektive, bashkë-krijim zgjidhjesh, prototipe.	Identifikim, Formulim, Zbatim, Vlerësim
Shkenca qytetare	Kur kërkon ndihmë për mbledhjen ose analizimin e të dhënave shkencore.	E përshtatshme për nisma shkencore më shumë se për politika. Kërkon pajisje ose mbështetje teknike.	Të dhëna, këshilla, vendimarrje për pyetje kërkimore.	Identifikim, Zbatim, Vlerësim
Monitorim qytetar	Kur kërkon mekanizma bashkëpunues për të monitoruar dhe vlerësuar vendime,	Kërkon pjesëmarrje të vazhdueshme dhe angazhim nga autoritetet për të marrë parasysh reagimet.	Reagime qytetare, opinione, sugjerime.	Zbatim, Vlerësim

	politika ose shërbime publike.			
Buxhetim pjesëmarrës	Kur kërkoni që qytetarët të ndihmojnë në përcaktimin e përparësive për shpenzimet publike.	Krijon kushtet për pjesëmarrje në vendimmarrje mbi buxhetin. Mund të jetë votim ose proces deliberativ.	Ide, projekte, përparësi, alokim i burimeve.	Identifikim, Formulim, Marrje vendimi, Zbatim
Proceset deliberative përfaqësuese	Kur kërkoni rekomandime kolektive dhe të mirëinformuara për çështje komplekse afatgjata.	Kërkon komunikim intensiv, burime njerëzore, metodologji të përshtatur, hapësirë fizike dhe facilitim profesional.	Rekomandime kolektive nga qytetarët, pozicionime, gjykime.	Identifikim, Formulim, Marrje vendimi, Vlerësim

4.1 Qasja në Informacion dhe të Dhëna

Niveli i parë i pjesëmarrjes është informimi. Autoritetet publike zakonisht janë të detyruara nga legjislacioni të publikojnë një sërë minimale informacioni dhe të dhënash publike, si në mënyrë proaktive ashtu edhe reaktive (pra, nëpërmjet legjislacionit për të drejtën e informimit ose të dhënave të hapura). Megjithatë, në këto udhëzues, informimi shihet si një parakusht për pjesëmarrje të informuar dhe si një mundësi për nivele më të fuqishme të pjesëmarrjes.

Kutia 1. Rast studimor: Qasja në Informacion

Në Shqipëri, një ndër platformat më të rëndësishme për qasjen e publikut në informacionin gjyqësor është Uebi i Gjykatës, një sistem elektronik i menaxhimit të çështjeve gjyqësore dhe publikimit të vendimeve. Kjo platformë ofron mundësi për qytetarët, gazetarët, studiuesit dhe organizatat e shoqërisë civile të kërkojnë dhe të shohin vendime gjyqësore që kanë hyrë në fuqi.

Burimi: <http://www.gjykatatirana.gov.al/>

KUTIA 1. RAST STUDIMOR: QASJA NË INFORMACION

a. Takimet publike/Mbledhjet e hapura

Mbledhjet e hapura janë mjete pjesëmarrëse që i kanë rrënjët që nga shekulli i 17-të në takimet e zonës së Neë England në SHBA apo në traditat koloniale të Amerikës Latine (si “cabildos”). Sot, këto procese përdoren në mbarë botën, më shpesh në nivel lokal apo legjislativ, për të ofruar informacion mbi veprimtarinë publike, për të inkurajuar pjesëmarrjen e qytetarëve dhe për të ndërtuar një marrëdhënie të bazuar në llogaridhënie dhe besim.

Karakteristikat

Mbledhjet e hapura synojnë të mbledhin qytetarët në takime ballë për ballë me autoritetet publike, për të ofruar informacion dhe për të diskutuar hapur tema me interes të përzgjedhura paraprakisht. Në dallim nga konsultimet publike, të cilat synojnë mbledhjen e kontributit të qytetarëve për një temë të caktuar, këto procese janë të bazuara në dialog dhe debat, jo në vendimmarrje apo arritje konsensusi (OECD, 2020[10]).

Qëllimet kryesore të tyre janë:

- Të informojnë qytetarët për vendimet e autoriteteve publike dhe t'i diskutojnë ato;
- Të afrojnë qytetarët me procesin e vendimmarrjes publike;
- Të rrisin transparencën publike.

Këto mbledhje mund të plotësohen me metoda të tjera pjesëmarrëse. Për shembull, një buxhet pjesëmarrës mund të shoqërohet me mbledhje të hapura për të prezantuar procesin, për të nxitur pjesëmarrjen dhe për të shpërndarë rezultatet.

Zakonisht, këto mbledhje janë të hapura për çdo banor të zonës ose për publikun e gjerë pa kufizime gjeografike. Megjithatë, nuk janë gjithmonë të dizajnuara për të qenë gjithëpërfshirëse, pasi përdorin mjete të kufizuara dhe shpesh tradicionale të komunikimit (si postera në rrugë), dhe për këtë arsye angazhojnë kryesisht qytetarët tashmë të interesuar, më tepër sesa të përfaqësojnë të gjithë spektrin e shoqërisë.

Mbledhjet e hapura zakonisht organizohen nga autoritetet publike në nivel lokal, për të ndarë informacione dhe diskutuar çështje të përditshme. Megjithatë, ato mund të organizohen edhe në nivele të tjera të qeverisjes, përfshirë nivelin kombëtar apo legjislativ.

4.2 Konsultimi Publik

Çfarë është konsultimi publik?

Konsultimi është një marrëdhënie me dy kahe, në të cilën qytetarët ofrojnë komente për një institucion publik (si për shembull: komente, perceptime, informacione, këshilla, përvoja dhe ide). Zakonisht, qeveritë përcaktojnë çështjet për konsultim, formulojnë pyetjet dhe menaxhojnë procesin, ndërsa qytetarët ftohen të japin mendimet dhe opinionet e tyre. (OECD, 2016[5]).

Karakteristikat

Konsultimet publike përdoren për të mbledhur ide, komente, sugjerime ose opinione në lidhje me një rregullore, një çështje politike apo një propozim paraprak (si për shembull: legjislacion, strategji, etj.). Një konsultim mund të ndihmojë në hartimin dhe formësimin e vendimeve, ose në identifikimin e mënyrave për përmirësimin e një zgjidhjeje apo politike tashmë të përcaktuara.

Konsultimet publike mund të përfshijnë si qytetarët ashtu edhe palët e interesuara. Kur përfshihen palët të interesuara (si për shembull organizatat joqeveritare), autoritetet publike mund të dërgojnë ftesa të synuara, por kur konsultimet janë të hapura për publikun e gjerë, organizatorët duhet të përgatisin një strategji të fortë komunikimi, për të siguruar një pjesëmarrje të lartë dhe për të përfshirë një gamë të ndryshme pjesëmarrësish.

Për të garantuar informim të gjerë dhe të barabartë të komunitetit, bashkitë duhet të përdorin një kombinim kanalesh komunikimi për njoftimin e konsultimeve publike, përtej rrjeteve sociale. Praktikë e raportuara tregojnë se mbështetja vetëm te Facebook nuk garanton përfshirje gjithëpërfshirëse. Rekomandohet përdorimi paralel i mediave lokale, njoftimeve fizike në njësitë administrative, bashkëpunimi me kryetarët e fshatrave dhe strukturat komunitare.

Konsultimet publike mund të zhvillohen në mënyra të ndryshme – në prani fizike, online, ose në formë hibride. Më poshtë paraqiten format më të zakonshme të tyre.

TABELA 3. LLOJET E KONSULTIMIT PUBLIK

Lloji i mekanizmit të konsultimit publik	Përshkrimi
Grupet e fokusit	Një mjet konsultimi që përdoret për të kuptuar preferencat e njerëzve ose për të vlerësuar propozime dhe ide. Zakonisht përfshijnë një grup qytetarësh që testojnë ose përfshijnë një shërbim, produkt apo zgjidhje dhe japin komente të detajuara. Zakonisht përfshijnë 8–10 persona dhe zgjasin më pak se një ditë.
Anketat	Ndihmojnë në identifikimin e opinioneve dhe preferencave të qytetarëve përmes një sërë pyetjesh të bëra nga institucionet publike. Mund të realizohen online ose fizikisht (për të arritur grupe që nuk kanë qasje të lehtë në internet). Anketat janë shpesh të hapura për këdo dhe rrallëherë përfaqësojnë një përfaqësim të vërtetë statistik.
Sondazhet e opinionit publik	Instrumente të njohura që tregojnë opinionet e një popullsie në një moment të caktuar. Janë të dobishme për të mbledhur mendimet e një kampioni të rastësishëm të publikut, duke siguruar përfaqësim statistikor të rezultateve.
Uorkshop-e, seminare, konferenca, diskutime në tryeza të rrumbullakëta	Përdoren për të mbledhur opinione të detajuara nga palët e interesit ose ekspertët dhe për të krijuar hapësira për shkëmbim idesh. Zhvillohen online ose fizikisht, me 20 deri në 150 pjesëmarrës. Grupet më të vogla janë më të përshtatshme për zhvillimin e ideve dhe shkëmbimin e mendimeve, ndërsa ngjarjet më të mëdha ndihmojnë për të vendosur kuadrin e debatit dhe për të rritur ndërgjegjësimin mbi çështjen e politikës.
Intervistat	Biseda individuale me ekspertë dhe palë të interesit për të mbledhur mendime dhe komente për një projekt, politikë apo shërbim. Mund të jenë të strukturuar (me pyetje të parapërcaktuara), gjysmë të strukturuar (me disa pyetje dhe zhvillim natyral të bisedës) ose të pastrukturuar (nisin me një pyetje të hapur dhe zhvillohen sipas përgjigjeve).

Burimi: Përpunim i autorit bazuar në OECD (2001), Citizens as Partners: OECD Handbook on Information, Consultation and Public Participation in Policy-Making; dhe CitizenLab (2019), FAQ on digital consultation, <https://www.citizenlab.co/ebooks-en/the-faqs-of-digital-consultation>

4.3 Inovacioni, mbledhja e ideve, Hakathonet dhe Sfidat Publike

Çfarë janë praktikat e inovacionit të hapur?

Praktikat e inovacionit të hapur, si mbledhja e ideve (crowdsourcing), hakathonet apo sfidat publike, janë mënyra për autoritetet publike që të përfitojnë nga inteligjenca kolektive për të bashkëkrijuar zgjidhje për çështje të caktuara publike. Inovacioni i hapur shpesh frymëzohet nga strategjitë e zhvillimit të biznesit ose teknologjisë, dhe mund të përkufizohet si “krijimi bashkëpunues i ideve dhe aplikimeve jashtë kufijve të një organizate të vetme” (Seltzer dhe Mahmoudi, 2012).

Karakteristikat

Metodat e inovacionit të hapur zakonisht përdoren për të mbledhur ekspertizë nga qytetarët dhe aktorët e interesit për të:

- gjetur ide apo frymëzim,
- pilotuar dhe testuar zgjidhje,
- apo për të përmirësuar shërbimet dhe metodat ekzistuese (GovLab, 2019).

Mbledhja e ideve (Crowdsourcing)

Mbledhja e ideve i referohet përdorimit të ekspertizës dhe ideve që vijnë nga masa (në këtë rast qytetarë dhe palë të interesuara). Ajo mund të përdoret për të mbledhur kontribute gjatë gjithë ciklit të një politike publike. Përmes platformave dixhitale ose aktiviteteve fizike, autoritetet publike mund të mbledhin mendime nga grupe ekspertësh, aktorë të synuar (si shkencëtarë apo zhvillues), apo publikun e gjerë për t'iu përgjigjur problemeve konkrete publike (GovLab, 2019).

Hakathonet (Hackathons)

Hakatonet (nga “hack” dhe “marathon”) janë ngjarje fizike ose virtuale që bashkojnë autoritete publike dhe aktorë të interesit për të punuar së bashku mbi ide, për të prototipuar zgjidhje dhe shërbime për të adresuar probleme publike. Qëllimi është të përfitohet nga larmia e aftësive, ekspertizës dhe profileve për të gjetur qasje të reja ose zgjidhje inovative.

Zakonisht, hakatonet përfshijnë komunitete teknike (zhvillues, programues, dizajnerë, shkencëtarë të të dhënave, etj.) për të shfrytëzuar të dhënat e publikuara më parë nga autoritetet (në format të dhënash të hapura). Hakatonet organizohen për një kohë të shkurtër (24 deri në 72 orë), ku pjesëmarrësit punojnë intensivisht për të zgjidhur një problem politikash ose për të ndërtuar zgjidhje dixhitale si p.sh. panele kontrolli, aplikacione, faqe interneti, etj.

Kutia 2. Hakathonet në France mbi tatimet dhe politikat fiskale

Ministria e Financave e Francës organizon hakathone të përsëritura për të përmirësuar algoritmet dhe aplikacionet e saj. Për shembull, në vitin 2016, Qeveria publikoi algoritmin e tatimeve për ta bërë të hapur për shqyrtim dhe përmirësim, si dhe për t'i dhënë mundësi zhvilluesve të krijojnë shërbime dhe aplikacione të reja. Kultura e hakathoneve është zgjeruar në të gjitha ministrinë në Francë dhe është përdorur, për shembull, për të përpunuar kolektivisht miliona komente të marra përmes platformave online gjatë Debatit të Madh Kombëtar (Grand Débat National).

Më shumë informacion mund të gjendet në këtë lidhje:

<https://www.etalab.gouv.fr/codeimpot-un-hackathonaautour-de-louverture-du-code-source-ducalculateur-impots>

KUTIA 2. HAKATHONET NË FRANCE MBI TATIMET DHE POLITIKAT FISKALE

Sfidat Publike

Sfidat publike janë mekanizma bashkë-krijimi ku qytetarët dhe aktorët e interesit propozojnë zgjidhje për probleme konkrete publike. Autoriteti publik shpall një problem apo sfidë specifike dhe më pas përzgjedh propozimet më të mira që vijnë nga publiku për të zgjidhur çështjen. Zgjidhjet mund të jenë propozime politikash, prototipe aplikacionesh celulari, sugjerime projektesh, etj. Qytetarët dhe palët e interesit paraqesin propozimet e tyre dhe, bazuar në kritere të publikuara paraprakisht, autoriteti përzgjedh zgjidhjet më të vlerësuara. Në disa raste, autoriteti publik jep një shpërblim për zgjidhjet e përzgjedhura (si kompensim financiar, njohje publike apo çmime të tjera). Më pas, autoriteti publik mund të zbatojë këto zgjidhje (si shërbime të reja publike ose si pjesë e një programi më të gjerë politik) ose të ofrojë mbështetje për zhvillimin e mëtejshëm të projekteve (si sesione trajnimi, fonde financiare, etj.).

4.4 Shkenca Qytetare

Çfarë është Shkenca Qytetare?

Shkenca qytetare ka një histori të gjatë, pasi entuziastë amatorë të shkencës, astronomisë, biologjisë dhe shkencave të tjera kanë eksploruar dhe vëzhguar botën përreth tyre prej mijëra vitesh. Me përparimin e teknologjive online, shkenca qytetare është bërë shumë më e njohur dhe efikase, dhe sot përdoret nga studiues, aktivistë dhe komunitete në mbarë botën. Thelbi i shkencës qytetare është që qytetarët përfshihen në një ose disa faza të një procesi kërkimor shkencor, si:

- identifikimi i pyetjeve kërkimore,
- kryerja e vëzhgimeve,
- analizimi i të dhënave,
- dhe përdorimi i njohurive të përfutuara.

Kjo është një mënyrë për të **demokratizuar procesin shkencor**, duke e hapur atë për njerëzit e zakonshëm dhe duke përfutur nga motivimi dhe kureshtja e tyre për të **bashkë-krijuar dhe avancuar objektivat kërkimore**.

Karakteristikat e shkencës qytetare

Qëllimi i përdorimit të metodave të shkencës qytetare	Përshkrimi dhe karakteristikat	Niveli i pjesëmarrjes
Si një mundësi për të mësuar	Qytetarët kanë mundësinë të mësojnë më shumë rreth një fushe apo çështjeje të caktuar. Kjo arrihet përmes: - aksesit të hapur në rezultatet e kërkimeve shkencore (si revista me akses të lirë), - ose organizimit të punëtorive të të nxënësve informal.	Informim
Si një qasje kërkimore	Qytetarët kontribuojnë në mbledhjen ose analizimin e të dhënave. Forca kryesore e përfshirjes së qytetarëve është: - sasia e madhe e të dhënave që mund të mbledhen, - diversiteti gjeografik i të dhënave, - mundësia për përpunim në shkallë të gjerë. Shembuj: - Vëzhgime direkte (p.sh. numërimi i zogjve në lagje), - Përdorimi i pajisjeve teknike (p.sh. matës të cilësisë së ajrit).	Konsultim ose përfshirje, në varësi të mandatit të dhënë qytetarëve
Si një metodë për përfshirje në projektim kërkimor	Qytetarët ndihmojnë në: - formulimin e pyetjeve kërkimore, - hartimin e projektit, - përcaktimin e fokusit të studimit. Përfshirja e tyre sjell: - përvojë lokale dhe njohuri të drejtpërdrejta, - rritje të ndërgjegjësimit publik, - ndikim në hartimin e politikave publike.	Konsultim ose përfshirje, në varësi të mandatit të dhënë qytetarëve

Kutia 3. Studim rasti: Shkenca qytetare – Plastic Pirates

Kjo fushatë u iniciua nga Presidenca e përbashkët Portugeze, sllovene dhe gjermane e Këshillit të Bashkimit Evropian për vitet 2020 dhe 2021. Ajo synon të angazhojë nxënësit, mësuesit dhe shoqata të tjera në mbledhjen e të dhënave mbi ndotjen me plastikë në lumenjtë evropianë. Materialet e projektit janë të disponueshme për shkarkim nga faqja zyrtare e projektit, dhe grupet pjesëmarrëse (kryesisht klasat shkollore) mund të vizitojnë segmente të ndryshme të lumenjve për të: i) identifikuar dhe klasifikuar llojet e ndryshme të ndotjes me plastikë, ii) regjistruar të dhënat dhe t'i ngarkojnë në një hartë dixhitale interaktive. Rezultatet kontribuojnë në kërkimin shkencor dhe ndihmojnë në plotësimin e boshllëqeve ekzistuese mbi sasinë dhe llojet e mbetjeve plastike në lumenjtë evropianë.

Më shumë informacion në: <https://www.plastic-pirates.eu/en>

KUTIA 3. STUDIM RASTI: SHKENCA QYTETARE – PLASTIC PIRATES

Çfarë është monitorimi qytetar?

Monitorimi qytetar i referohet përfshirjes së publikut në monitorimin dhe vlerësimin e vendimeve, politikave dhe shërbimeve publike. Kjo metodë pjesëmarrëse mund të konsiderohet gjithashtu si një mjet i **përgjegjshmërisë vertikale apo sociale**, pasi i lejon qytetarët dhe palët e interesuara të marrin pjesë drejtpërdrejt në mbajtjen përgjegjëse të autoriteteve publike për vendimet dhe veprimet e tyre.

Karakteristikat

Institucionet publike mund të përfitojnë ndjeshëm nga krijimi i kanaleve të reagimit (feedback) që u japin mundësi qytetarëve të ofrojnë sugjerime, komente dhe ankesa, për të përmirësuar vendimet, veprimet dhe shërbimet e ofruara. Përfshirja e qytetarëve dhe palëve të interesuara në mbikëqyrjen dhe vlerësimin e vendimmarrjes institucionale ndihmon në ndërtimin e një **qarku pozitiv** dhe marrëdhëniesh më të shëndetshme që rrisin besimin ndaj qeverisjes.

Monitorimi qytetar mundëson që publiku të ndjekë nga afër fusha kyçe të veprimit qeveritar, si për shembull:

- **Buxheti publik:** Hapja e buxheteve dhe e menaxhimit të financave publike, si dhe krijimi i hapësirave për pjesëmarrje të drejtpërdrejtë të qytetarëve, u jep atyre mundësi për të ofruar komente në kohë reale dhe për të bashkëpunuar për të përmirësuar shpenzimet publike. Kjo qasje ndihmon në **uljen e korrupsionit dhe shpërdorimit**, si dhe në **rritjen e probabilitetit që taksat të përkthehen në shërbime cilësore publike** dhe përmirësime reale në standardet e jetesës dhe në rezultatet sociale, ekonomike dhe mjedisore (OECD, 2017[16]).
- Përveç përgjegjshmërisë në mbledhjen e të ardhurave, qeveritë duhet të jenë të përgjegjshme edhe për **menaxhimin dhe zbatimin e buxhetit**. Në mënyrë konkrete, qytetarët dhe palët e interesuara mund të monitorojnë dhe vlerësojnë buxhetin duke shqyrtuar informacionin dhe të dhënat e publikuara nga institucionet publike, apo duke verifikuar nëse fondet janë përdorur sipas qëllimit të parashikuar.

TABELA 4. TIPOLOGJIA E MEKANIZMAVE TË MONITORIMIT QYTETAR

	Përshkrimi i mekanizmit
Sondazhet e opinionin publik	Sondazhet pjesëmarrëse janë mjete të fuqishme që synojnë të marrin mendimin e qytetarëve mbi cilësinë dhe performancën e shërbimeve publike, si arsimi fillor dhe i mesëm, kujdesi shëndetësor, transporti publik dhe rrjeti i furnizimit me ujë. Këto sondazhe dhe kartelat e raportimit angazhojnë drejtpërdrejt qytetarët në vlerësimin e cilësisë së shërbimeve publike në terma të cilësisë, aksesit dhe disponueshmërisë. Qeveritë mund të mbledhin në mënyrë sistematike këtë feedback, ta publikojnë periodikisht në faqet e tyre zyrtare dhe ta përdorin këtë informacion për të matur kënaqësinë e qytetarëve me shërbimet publike me kalimin e kohës.
Kartelat e raportimit të qytetarëve (CRC)	Një kartelë raportimi mbi shërbimet publike nuk është thjesht një sondazh tjetër. Kartelat reflektojnë përvojën reale të njerëzve me një gamë të gjerë shërbimesh publike, duke mbledhur mendimet e përdoruesve mbi performancën e ofruesve të shërbimeve. Gjatë procesit të një CRC-je, mbledhen të dhëna sasiore dhe perceptime nga sondazhe përfaqësuese statistikisht, që do të thotë se gjetjet reflektojnë opinionet dhe perceptimet e grupit të qytetarëve nga të cilët kërkohet informacioni. Kështu, ky është një mjet i vlefshëm për të vendosur të dhëna fillestare të sakta, për të matur mbulimin dhe performancën e shërbimeve, si dhe për të identifikuar pabarazitë në ofrimin e tyre.
Auditimet sociale	Mekanizëm për të mbajtur komunitetin të informuar mbi shërbimet qeveritare dhe për t'i dhënë qytetarëve mundësinë për të mbajtur institucionet përgjegjëse. Këto auditime janë shqyrtime formale të objektivave, proceseve vendimmarrëse dhe përdorimit të burimeve publike në institucionet publike. Proceset e auditimit social mund të ndihmojnë në fokusimin mbi performancën dhe/ose sjelljen e qeverisë,

	denoncimin e praktikave korruptive ose shpërndarjen e informacionit mbi deklaratat e pasurisë së zyrtarëve publikë para zgjedhjeve. Aktivitetet e auditimit social mund të zhvillohen në çdo fazë të ciklit të politikëbërjes dhe ndihmojnë në matjen e përputhshmërisë midis rezultateve të pritshme dhe atyre reale.
Gjurmimi i shpenzimeve publike	Gjurmimi i shpenzimeve publike përfshin ndjekjen e rrjedhës së burimeve publike për ofrimin e mallrave apo shërbimeve publike, nga burimi deri në destinacion. Ky është një mekanizëm për përfshirjen e qytetarëve dhe shoqërisë civile në monitorimin e përdorimit të burimeve publike dhe për rritjen e efikasitetit nga autoritetet publike si dhe uljen e korrupsionit apo keqpërdorimit.
Mjetet online	Qytetarët gjithashtu mund të monitorojnë veprimet publike dhe të raportojnë në një komunitet më të gjerë përmes përdorimit të aplikacioneve, forumeve virtuale, rrjeteve sociale apo faqeve të dedikuara në internet. Është gjithnjë e më e zakonshme që qytetarët të shprehin ankesat e tyre në rrjetet sociale mbi degradimin e një hapësire publike, ose të vlerësojnë publikisht përvojën e tyre gjatë përdorimit të një shërbimi publik – pozitivisht apo negativisht. Gjithnjë e më shumë bashki lokale po krijojnë aplikacione celulare të dedikuara apo platforma digjitale për këtë qëllim.
Proceset përfaqësuese dhe deliberative	Gjatë këtyre proceseve, qytetarë të përzgjedhur në mënyrë të rastësishme – që përfaqësojnë një mikrokozmos të komunitetit – kalojnë kohë të konsiderueshme duke mësuar dhe bashkëpunuar përmes diskutimeve të lehtësuara me qëllim hartimin e rekomandimeve të informuara kolektive për autoritetet publike. Autoritetet publike janë të detyruara të bëjnë publike të gjitha informacionet përkatëse lidhur me çështjen e politikës apo shërbimit, si dhe të raportojnë mbi rekomandimet e dhëna nga qytetarët. Ky lloj procesi mund të përdoret për t'u mundësuar qytetarëve të vlerësojnë një shërbim publik apo një politikë publike duke dhënë rekomandime për përmirësimin e ofrimit apo zbatimit të saj. Gjithashtu, mund të krijohen edhe panele të qëndrueshme që monitorojnë një politikë apo projekt të caktuar gjatë një periudhe kohe.

4.5 Buxhetimi me pjesëmarrje

Çfarë është buxhetimi pjesëmarrës?

Buxhetimi me pjesëmarrje është një mënyrë demokratike që u jep njerëzve të drejtën e drejtpërdrejtë për të vendosur se si do të shpenzohen paratë publike. Ai nisi në vitin 1989 në Porto Alegre, në jug të Brazilit. Vetëm në Brazil, ky mekanizëm pjesëmarrës u përhap në më shumë se 436 bashki, dhe sot numërohen mbi 11,000 përvoja të buxhetimit me pjesëmarrje në mbarë botën. (OECD, 2022)

Karakteristikat

Një buxhet pjesëmarrës i referohet mekanizmave që u lejojnë qytetarëve dhe aktorëve të interesuar të ndikojnë në vendimet publike përmes shpërndarjes së drejtpërdrejtë të burimeve publike në prioritetet apo projektet e tyre. Atlasi Botëror i Buxhetimit me Pjesëmarrje (2021) e përkufizon si një *“proces që përfshin një pjesë të caktuar ose të gjithë buxhetin e një institucioni, që mund të vendoset lirshëm dhe në mënyrë të pavarur nga të gjithë qytetarët pjesëmarrës në iniciativë”*.

Këto udhëzime identifikojnë dy lloje të buxhetimit pjesëmarrës:

Procese të bazuara në projekte: një shumë e paracaktuar e buxhetit i alokohet projekteve dhe ideve të qytetarëve. Shuma varet nga secili autoritet dhe mund të arrijë deri në 100 milionë euro në vit, si në Paris (Francë), ku pjesa më e madhe e buxhetit i nënshtrohet votimit qytetar.

Procese të ciklit buxhetor: qytetarët dhe aktorët e interesuar mund të marrin pjesë në të gjithë ciklin e buxhetit, duke dhënë komente ose rekomandime mbi buxhetin e përgjithshëm apo prioritetet strategjike. Kjo mund të

realizohet përmes krijimit të një organi të posaçëm pjesëmarrës ose duke ftuar pjesëmarrës në struktura vendimmarrëse publike si komisionet e buxhetit.

Kutia 4. Takim i hapur për buxhetimin me pjesëmarrje në Korçë

Buxheti me pjesëmarrje, projekt i realizuar çdo vit nga Bashkia Korçë, i cili synon të marrë mendimin e qytetarëve për destinacionin që do të ketë buxheti i bashkisë, mënyrën se si do të shpërndahet për zbatimin e projekteve të ndryshme dhe renditjen sipas prioriteteve të qytetarëve në lidhje me to. Buxheti me pjesëmarrje përfshin edhe pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm në lidhje me taksat, si dhe është një proces i konsultimit të prioriteteve të investimeve me banorë të të gjitha lagjeve të qytetit. Qytetarët votojnë listën e propozuar nga bashkia dhe projektet që marrin numrin më të lartë të votave bashkia i kalon për financim dhe zbatim.

Burimi: www.bashkiakorce.gov.al


KUTIA 4. TAKIM I HAPUR PËR BUXHETIMIN ME PJESËMARRJE NË KORÇË

4.6 Proceset përfaqësuese (deliberative)

Çfarë është një proces përfaqësues deliberativ?

Proces përfaqësues deliberativ: një proces në të cilin një grup njerëzish i përzgjedhur në mënyrë përfaqësuese dhe të gjerë shqyrton prova, zhvillon diskutime për të gjetur një qëndrim të përbashkët dhe harton rekomandime të detajuara mbi çështje politike për autoritetet publike (OECD, 2021[20]). Shembuj të zakonshëm të këtyre proceseve njëherësh janë asambltetë qytetare, juritë dhe panelet. Përdorimi i këtyre proceseve, i njohur si “vala deliberative”, ka qenë në rritje që nga vitet 1980, duke fituar vull veçanërisht pas vitit 2010.

FIGURE 1. ÇFARË ËSHTË PROCESI PËRFAQËSUES?



Karakteristikat

Një proces përfaqësues deliberativ është më i përshtatshëm për të trajtuar llojet e mëposhtme të problemeve:

- Dilema të bazuara në vlera;
- Probleme komplekse që kërkojnë kompromise dhe prekin grupe të ndryshme në mënyra të ndryshme;
- Çështje afatgjata që shkojnë përtej cikleve zgjedhore.

Ka dy elementë që e bëjnë procesin përfaqësues deliberativ të ndryshëm nga metodat e tjera të pjesëmarrjes qytetare:

- **Përzgjedhje e rastësishme e pjesëmarrësve përmes një llotarie qytetare.** Për të mundur një diskutim të thellë dhe domethënës, grupi i qytetarëve pjesëmarrës duhet të jetë relativisht i vogël, zakonisht nga 15 deri në 100 persona. Përzgjedhja e rastësishme e qytetarëve, e shtresuar sipas kriterëve si mosha, gjinia, vendndodhja dhe sfondi socio-ekonomik, ka për përfitim kapjen e shumëllojshmërisë së pikëpamjeve, perspektivave dhe përvojave të jetës së grupeve të ndryshme të shoqërisë, duke siguruar përfaqësim të gjerë të komunitetit. Edhe pse grupi është më i vogël se në disa

procese të tjera pjesëmarrëse, ai është projektuar për të siguruar përfshirje dhe për të përfaqësuar edhe komunitetet apo zërat që zakonisht janë më të vështirë për t'u arritur.

- **Diskutim deliberativ.** Diskutimi deliberativ përfshin dialog dhe debat, por gjithashtu nënkupton shqyrtim të kujdesshëm të një game të gjerë argumentesh dhe opinionësh në mënyrë të respektueshme. Kërkon informacion të saktë dhe të rëndësishëm, si dhe kohë të mjaftueshme, në mënyrë që pjesëmarrësit të mund të futen në thelbin e çështjes dhe të gjejnë një bazë të përbashkët.

Në përgjithësi, për shkak të këtyre veçorive, proceset përfaqësuese deliberative përqendrohen në thellësinë e diskutimit dhe përfaqësimin e të gjitha pjesëve të shoqërisë brenda një grupi të vogël, ndërsa shumica e metodave të tjera të pjesëmarrjes qytetare përqendrohen në gjerësinë e pjesëmarrjes – duke synuar që të përfshijnë drejtpërdrejt të gjithë ata që preken nga një çështje specifike (Carson dhe Elstub, 2019; OECD, 2020).

Kutia 5. Asambleja Qytetare në Belgjikë

Në vitin 2019-2020, në Belgjikë u mbledhën 100 qytetarë të përzgjedhur në mënyrë të rastësishme (llojari qytetare), të përfaqësuar në mënyrë të baraspeshuar sipas moshës, gjinisë, rajonit dhe sfondit socio-ekonomik. Qëllimi ishte të zhvillohen rekomandime konkrete për politikën klimatike afatgjatë dhe të qëndrueshme për Belgjikën, që synojnë të përmbushin angazhimet kombëtare dhe ndërkombëtare për reduktimin e emetimeve të karbonit. Rekomandimet e dala ndihmuan në hartimin e Strategjisë Kombëtare për Klimën 2030 dhe mundësoi forcimin e besimit publik ndaj institucioneve përmes përfshirjes së drejtpërdrejtë. Ky model u vlerësua pozitiv dhe është shtrirë në vende të tjera si Irlandë, Çeki.

KUTIA 5. ASAMBLEJA QYTETARE NË BELGJIKË

KREU 5. PRAKTIKA TË MIRA DHE MODELE FRYMËZUESE

Pjesëmarrja në vendet e bashkimit Evropian rregullohet përgjithësisht me anë të ligjeve dhe rregulloreve ose përmes kodeve dhe standardeve. Megjithatë ka vende evropiane që i përdorin të dyja këto instrumente, ligjore dhe joligjore. Vlen të theksohet se në disa vende e drejta e pjesëmarrjes është e rregulluar madje dhe në kushtetutë.

5.1 Shembuj evropiane të pjesëmarrjes në menaxhim mjedisor

Gjermania

Përqasja aktuale e qeverisë gjermane ndaj angazhimit qytetar është fortësisht e ndikuar nga nocioni i kapitalit social. Kështu angazhimi social është në një masë të madhe i vetë- organizuar. Në Gjermani, kushtetuta nuk lejon përdorimin e metodave të pjesëmarrjes në nivel federal, megjithatë landet kanë adoptuar rregullore të cilat ndihmojnë në nxitjen e pjesëmarrjes qytetare.¹⁷ Për fusha të caktuara, pjesëmarrja qytetare garantohet me ligje ku thuhet se publiku duhet të konsultohet në projektet e zhvillimit.

Në Gjermani ekzistojnë dy institucione, raportet e të cilave mbi pjesëmarrjen qytetare përcaktojnë politikën gjermane dhe kuadrin institucional për pjesëmarrjen publike:

1. Një komitet në Bundestagun gjerman, i cili merret ekskluzivisht me pjesëmarrjen

e qytetarëve

2. Një komision i posaçëm (komisioni Enquete) për angazhimin qyteta

Në nivel qyteti, aktivitetet më të spikatura janë pjesëmarrja në diskutimin e buxhetit. Gjithmonë e më shumë qytetarët gjermanë po i venë theksin elementëve specifikë në buxhet ku ato vendosin për vendimet e investimeve publike.¹⁸ Por megjithatë nuk ka mekanizma për të matur rezultatet e pjesëmarrjen qytetare në procesin politikëbërës.

Një studim i zhvilluar nëpërmjet email-it në Gjermani për përfshirjen e qytetarëve nëvendimmarrje dhe mekanizmave të kësaj pjesëmarrjeje publike tregoi se metodat më të përdorura për të përçuar informacionin nga institucionet publike ishin faqet online, shtypi i shkruar dhe stacionet e radiove lokale. Referuar mënyrave për tu konsultuar me qytetarët sondazhet, takimet me publikun, debatet dhe ëorkshonet rezultuan mekanizma që gjenin përdorim më të gjerë.

Në mënyrë të përmbledhur mund të themi se në Gjermani nuk ekziston një përqasje e unifikuar sa i takon pjesëmarrjes qytetare dhe çdo institucion vendos në mënyrë të pavarur për proceset e pjesëmarrjes, në mungesë të një strategjie qendrore për përmirësimin e pjesëmarrjes qytetare. Nga ana tjetër, angazhimi qytetar fokusohet më tepër në çështje sociale dhe jo në çështje politike. Vlen të theksohet se shoqëria civile në Gjermani është e fortë dhe ka një tërësi aktorësh aktivë dhe të gatshëm për të dedikuar kohë dhe përpjekje.

Kutia e Praktikës Gjermania: “Green Belt” (Brezi i Gjellbër)
së Mirë

¹⁷ European Urban Knowledge Network, ‘Public Participation in the Development Process: Obtaining insight in European experiences’, <http://www.eukn.eu/fileadmin/Lib/files/EUKN/2013/Factsheet.pdf>

¹⁸ European Institute for Public Participation (EIPP), ‘Public Participation in Europe: An International Perspective’, 2009, http://www.partizipation.at/fileadmin/media_data/Doenloads/Zukunftsdiskurse-Studien/pp_in_e_report_03_06.pdf

Përshkrimi i rastit:	Pas rënies së Murit të Berlinit dhe fillimit të ribashkimit gjerman, kufirit ndërmjet RDGJ dhe BRD (i njohur si “vija e vdekjes”) u shndërrua në korridor natyror me forcë të vetë-ripërtëritjes. Në vitin 1989, BUND (Bund für Umwelt und Naturschutz Deutschland) së bashku me BfN (Federal Agency for Nature Conservation), nisën inventarizimin e florës dhe faunës në të gjithë vijën (~1 393 km) dhe më pas e mbajtën në funksion si një korridor ekologjik i pandërprerë me mbulueshmëri në 177 km² të habitateve të ndryshme, përfshirë 146 lloje habitatësh, nga të cilat 64 % janë në listën e kuqe të rrezikuar, dhe 98 % përfshihen në rrjetin evropian Natura 2000 (ëëë.europeangreenbelt.org)	
Aktorët dhe mekanizmat:	Përveç agjencive qeveritare (BfN) dhe jo-qeveritare (BUND), në projekt përfshiheshin edhe autoritetet lokale, fermerët, shoqata të mirëmbajtjes së tokës dhe komunitetet rurale. Qeverisja u realizua përmes konferencave ndërkombëtare (Bonn 2003), uorkshoope rajonale, projekteve pilot për lidhje ekologjike (“Cross-linking Green Belt”), si për shembull krijimi i 200 ha zonë verifikimi të lidhjeve ekologjike në disa rajone, duke përfshirë Shqipërinë. Transformim i zonës jo-njerëzore të kufirit në korridor vital për biodiversitetin, që lidh të gjitha peizazhet gjermane (nga ultësirat deri te malësitë) .Ruajtje e specieve të rralla: 1 200+ specie të mbrojtura përfshirë storkën e zezë, qen ujqor, orchide të rralla . Tema kombëtare e ruajtjes së natyrës dhe turizëm i qëndrueshëm, me shtigje ecjeje, sinjalistikë, ekspozita historike përkushtuar kujtesës së ndarjes së Gjermanisë . Model për iniciativën European Green Belt, 12 500 km gjatë vijës së Ish-Perdes së Hekurt në 24 vende, me koordinim trajnimi dhe mbështetje financiare nga IUCN, BfN, EuroNatur dhe EGBA.	
Mësime të nxjerra:	• Përdorimi i trashëgimisë historike si mundësi për ndërtimin e korridoreve ekologjike ka impakt të lartë social dhe ekologjik • Qeverisja pjesëmarrëse kombinon qëndrueshmërinë ekologjike me turizmin lokal dhe ruajtjen e kujtesës historike. • Zbatimi i prototipeve rajonale (p.sh. lidhje ekologjike 200 ha aktiviteteve lokale) mund të shtrihet në mbarë Shqipërinë për ruajtjen dhe rivendosjen e ekosistemeve. • Ky model shërben si një shembull inspirues për vende të tjera që duan të krijojnë korridore ekologjike të gjera dhe të qëndrueshme, duke përdorur mekanizma bashkëpunimi institucional, mbrojtje ligjore, ndërgjegjësim publik dhe turizëm të kujdesshëm.	

KUTIA 6. KUTIA E PRAKTIKËS SË MIRË – GJERMANIA: “GREEN BELT” (BREZI I GJELBËR)

Kroacia

Në Kroaci e drejta e pjesëmarrjes është e përcaktuar në kushtetutë. Në Kroaci përdoren si instrumentet ligjorë dhe joligjorë për sigurimin e pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje. Ligji për të Drejtën e Informimit parashikon 5 mënyra për dhënien e informatave: i) dhënien e rregullt të informatave të caktuara ii) dhënien e informatave drejtpërdrejtë tek personi që i kërkon ato iii) lejimin e qasjes në dokumente iv) dërgimin e dokumenteve dhe informatave të kërkuara drejtpërdrejtë tek personat që i kanë kërkuar v) në mënyra të tjera. Institucionet Publike duhet të sigurojnë pjesëmarrje qytetare të drejtpërdrejtë në takimet apo seancat e tyre dhe duhet të caktojnë një person përgjegjës për të ofruar informim të vazhdueshëm.¹⁹

¹⁹ Open Society Foundation, V. Loëndes, ‘Citizen Participation in South Eastern Evrope’, 2012, <http://aarhus.ba/sarajevo/images/docs/Igi%20citizen%20participation%20ed%20loëndes-9-13-2012.pdf>

Kutia e Praktikës së Mirë – Pjesëmarrja Publike i Parkut Natyror - Kroaci

Një rast i suksesshëm i pjesëmarrjes publike në Kroaci është ai i Parkut Natyror “Vransko Jezero”, ku që nga viti 2006 u zbatua një proces gjithëpërfshirës për hartimin dhe zbatimin e planit të menaxhimit të parkut. Autoritetet kombëtare dhe vendore përfshinë aktivisht banorët lokalë, organizatat e shoqërisë civile, operatorët turistikë dhe peshkatarët përmes takimeve konsultative, grupeve të fokusit dhe mekanizmave të komenteve publike. Kjo qasje çoi në hartimin e një plani të qëndrueshëm, të pranuar nga të gjithë aktorët, duke përmirësuar marrëdhëniet ndërmjet administratës së parkut dhe komunitetit. Si rezultat, u fuqizua ndjeshëm ndjenja e pronësisë dhe u krijuan mundësi të reja për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm lokal. Ky rast dëshmon se përfshirja kuptimplote e komunitetit jo vetëm rrit besimin dhe legjitimitetin institucional, por edhe ndihmon në krijimin e zgjidhjeve afatgjata dhe të pranueshme për të gjithë.

(Burimi: UNECE Aarhus Clearinghouse, 2008;WWF Adria, 2016)

KUTIA 7. KUTIA E PRAKTIKËS SË MIRË – KROACI

5.2 Përvoja të suksesshme në Shqipëri dhe rajon

a. Praktika e buxhetimit me pjesëmarrje në Bashkinë Korçë

Bashkia Korçë është një nga shembujt pozitivë në Shqipëri për zbatimin e **buxhetimit me pjesëmarrje**. Ky proces zhvillohet çdo vit dhe synon përfshirjen direkte të qytetarëve në përcaktimin e destinacionit të buxhetit bashkiak. Qytetarët votojnë për prioritetet e investimeve në lagjet e tyre bazuar në një listë të paraqitur nga bashkia. Projektet që marrin numrin më të madh të votave kalojnë për financim dhe zbatim. Ky proces përfshin gjithashtu konsultimin me bizneset e vogla dhe të mesme, sidomos për çështjet që lidhen me taksat.

Një tjetër mekanizëm i rëndësishëm në Korçë është **Komisioni Këshillimor Qytetar Vendor (KKQV)**, një strukturë prej 70 anëtarësh që përfaqëson komunitetin përmes përfaqësuesve nga profesione të ndryshme dhe organizata të shoqërisë civile. Komisioni zhvillon dy mbledhje në muaj dhe ndihmon në diskutimin dhe adresimin e sfidave të komunitetit. Qytetarët janë përfshirë me sukses edhe në projekte të tilla si rikualifikimi i zonës së pazarit apo rruga pedonale, ku opinionet e tyre janë marrë në konsideratë në mënyrë efektive.

b. Praktika e pjesëmarrjes qytetare në Bashkinë Shkodër

Në Shkodër, pjesëmarrja qytetare është ndërtuar më së shumti rreth transparencës dhe komunikimit me komunitetin. Një praktikë e përdorur është **vlerësimi i komunitetit për qeverisjen**, ku zhvillohen takime të përvitshme me shoqërinë civile për të diskutuar performancën e qeverisjes. Megjithatë, kjo praktikë është vlerësuar si jo mjaftueshëm e shpeshtë dhe me përfshirje të kufizuar të qytetarëve të zakonshëm.

Për shpërndarjen e informacionit, Bashkia Shkodër përdor transmetimet “live” të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak në katër stacione televizive lokale, që ndihmon qytetarët të ndjekin vendimmarrjet. Gjithashtu, është ndërtuar një zyrë me një ndalesë për informim, si dhe përdoren rrjetet sociale dhe faqja zyrtare për komunikim me qytetarët. Në zonat e largëta, informacioni përcillet përmes administratorëve të njësive dhe kryepleqve. Bashkia ka miratuar edhe marrëveshje me OJF-të për ofrimin e shërbimeve për grupet në nevojë. Megjithatë, sipas vlerësimeve të marra në studim, bashkëpunimi nuk është i qëndrueshëm dhe mungon një qasje e strukturuar për të përfshirë qytetarët në mënyrë aktive në proceset vendimmarrëse.

Referenca

- Auron Pasha, Blerta Selenica, Blerta Kalavace, Lorena Zajmi. (2017). *Udhërrëfyes për përfshirjen qytetare në qeverisjen vendore*. Tirane: IDRA.
- EcoAlbania. (2025, may 15). *Ecoalbania*. Gjetur në <https://ecoalbania.org>: <https://ecoalbania.org/iscca-menaxhimi-i-qendrueshem-i-korridoreve-ekologjik-ne-zonen-e-polis-valamare-rungaje-morave-gramoz/>
- EcoAlbania. (2025). *Plan Veprimi: Zhvillimi i Qëndrueshem i CCA 'Polis-Valamarë-Rungajë-Moravë-Gramoz'*. Ecoalbania.
- GovLab. (2019). *Collective Intelligence and Governing Series the Open Policymaking Playbook*.
- Kuvendi. (1998). *Ligji nr.8548, datë 11.11.1998, "Për Ratifikimin e Kartës Europiane të Autonomisë Vendore"*. Fletorja Zyrtare.
- Kuvendi. (2011). *Ligji nr. 10431, datë 9.06.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit"*, i ndryshuar. Fletorja Zyrtare.
- Kuvendi. (2014). *Ligji nr.115, datë 31.07.2014, "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë"*. Fletorja Zyrtare.
- Kuvendi. (2014). *Ligji nr.119/2014, "Për të drejtën e informimit"*. Fletorja Zyrtare.
- Kuvendi. (2014). *Ligji nr.146/2014, "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik"*. Tirane: Fletorja Zyrtare.
- Kuvendi. (2015). *Ligji nr.139 datë 17.12.2015, "për vetqeverisjen vendore"*, i ndryshuar. Tirane: Fletorja Zyrtare.
- Kuvendi. (2022). *Udhëzues për pjesëmarrjen publike*. Tiranë: Kuvendi i Shqipërisë.
- Muco, P. (2023). *Analiza e potencialit agroturistik dhe impaktit socioekonomik në Polis-Valamarë-Rungajë-Moravë-Gramoz CCA*. Tiranë: EcoAlbania & pont.
- OECD. (2022). *Guidelines for Citizens Participation Processes, OECD Public Governance Reviews*. Paris: OECD Publishing,. Gjetur në ISBN 978-92-64-66299-5 (pdf)
- Qirjo, M. (2024). *VLERËSIMI I GJENDJES AKTUALE TË "POLIS-VALAMARË-RUNGAJE-MORAVË-GRAMOZ CCA"*. Tirana: Ecoalbania & Pont.
- RSH. (1999). *Ligji nr.8548 datë 11.11.1999 "Për ratifikimin e Kartës Europiane të Autonomisë Vendore"*. Tiranë: Fletorja Zyrtare.
- UN. (2013). *Citizens Engagement and the Post-2015 Development Agenda: Report of the Expert Group Meeting*. UN. Gjetur në <http://eorkspace.unpan.org/sites/Internet/Documents/EGM%20Report-Beirut-3->
- UNECE. (2006). *A simplified guide to Aarhus Convention*. Geneva: UNECE. doi:ISBN 92-1-1-116943
- Vendim. (2008). *Nr.994, datë 02.07.2008, "Për tërheqjen e mendimit të publikut në vendimmarrje për mjedisin"*. Fletorja Zyrtare.
- Vendim. (2012). *Nr.6, datë 4.1.2012, "Për të drejtën e publikut për të pasur informacion mjedisor"*. Fletorja Zyrtare.
- Vendim. (2019). *Nr.636, datë 25.09.2019 "Për miratimin e kritereve dhe të procedurave të shpalljes dhe administrimit të parqeve natyrore bashkiake"*. Fletorja Zyrtare.

Shtojca A: Listë kontrolli për bashkitë për planifikimin e procesit të pjesëmarrjes publike në zonën e Korridorit

Kjo listë kontrolli mund të përdoret nga çdo autoritet publik si një udhëzues hap pas hapi për planifikimin dhe zbatimin e procesit të pjesëmarrjes publike.

Hapi 1 : Identifikimi i problemit për tu zgjidhur dhe momenti i pjesëmarrjes publike

Në cilën fazë të projektit ose politikës jeni? Ju lutem zgjidhni një:

- Faza e përcaktimit të problemit
- Faza e formulimit të politikës apo projektit
- Faza e vendim-marrjes
- Faza e zbatimit
- Faza e vlerësimit

Kush është problemi që qytetarët (ose palët e interesit) mund të ndihmojnë në adresim?

Si mund t'iu ndihmojnë qytetarët/ palët e interesit për të zgjidhur problemin?

Hapi 2: Përcaktimi i rezultatit të pritshëm

Çfarë lloj inputi do të donit të merrnit nga pjesëmarrësit? Zgjidhni një ose më shumë:

- Ide dhe propozime
- Opinione të përgjithëshme
- Ekspertizë dhe këshilla teknike
- Rekomandime të informuara
- Aksione konkrete
- Lajmërime dhe komente
- Vendimmarrje direkte
- Fakte dhe evidenca
- Tjetër

Si do ti përdorni këto inpute për të zgjidhur problemin që keni identifikuar? Ju lutem zgjidhni:

- Vetëm për konsultim
- Do ti përdorim për frymëzim
- Do ti përdorim për tu informuar për vendim-marrjen tonë
- Do të zbatojmë disa nga inputet
- Do të zbatojmë të gjitha inputet
- Nuk jemi të sigurtë akoma

Hapi 3: Përcaktimi i autoritet publik përkatës për tu angazhuar pjesëmarrës

Duke pasur parasysh çështjen politike ose sfidën publike në fjalë, cilat grupe duhet të përfaqësohen ndër pjesëmarrësit? Ju lutem zgjidhni një ose më shumë:

- ☐ Mostër përfaqësuese qytetarësh
- ☐ Grup qytetarësh jo përfaqësues, por të larmishëm
- ☐ Grup qytetarësh me aftësi të veçanta

- ☐ Ekspertë dhe profile teknike
- ☐ Aktorë të interesuar që përfaqësojnë opinione të ndryshme (OJQ, sindikata biznesi, etj.)
- ☐ Banorë të një zone të caktuar
- ☐ Një grup specifik qytetarësh
- ☐ Publik më i gjerë
- ☐ Tjetër:

Duke u bazuar në nevojat e treguara më sipër, cilën metodë rekrutimi do të përdorni? Ju lutem zgjidhni një:

- ☐ Thirrje e hapur
- ☐ Thirrje e mbyllur
- ☐ Ansamble qytetare

Sa persona duhet të përfshihen?

Si do të siguron – dhe mbani – interesin e pjesëmarrësve gjatë gjithë procesit?

Hapi 4: Zgjedhja e metodës së pjesëmarrjes

Përcaktoni se cila metodë i përgjigjet më mirë nevojave tuaja, siguron llojin e inputeve që dëshironi, dhe është e realizueshme duke marrë parasysh kohën dhe burimet tuaja:

- ☐ mbledhje të hapura / mbledhje komunale
- ☐ konsultim publik
- ☐ inovacion i hapur: croëdsourcing, hakathonë dhe sfida publike
- ☐ shkencë qytetare
- ☐ monitorim civil
- ☐ buxhetim përfshirës
- ☐ procesi përfaqësues i deliberimit

Hapi 5: Përzgjedhja e mjeteve dixhitale të përshtatshme

A do të përdorni një platformë online dhe/ose një mjet digjital?

- ☐ Po
- ☐ Jo

Nëse po, si e parashikoni që pjesëmarrësit të përdorin mjetin digjital në kontekstin e procesit tuaj pjesëmarrës?

- ☐ Propozimi i projekteve, ideve ose sugjerimeve të reja.
- ☐ Deliberimi për të arritur vendime të përbashkëta.
- ☐ Votimi mbi idetë ose projektet e propozuara.
- ☐ Prioritizimi i opsioneve të mundshme.
- ☐ Hartimi i strategjive, politikave ose legjislacionit.
- ☐ Ndarja e informacionit ose të dhënave për të plotësuar një mungesë ekzistuese.
- ☐ Për qëllime komunikimi.
- ☐ Tjetër:

Tregoni cilat mjet(e) digjitale do të përdoren:

Si do të siguronit që të gjithë të kenë akses dhe të jenë në gjendje t'i përdorin këto mjete?

Hapi 6: Komunikimi për procesin

Mendoni të krijoni një strategji komunikimi para, gjatë dhe pas procesit të pjesëmarrjes.

Përcaktoni cilat kanale do të përdorni për të komunikuar me pjesëmarrësit:

- ☐ Email
- ☐ Kanal online privat (Facebook, etj.)
- ☐ Kanal online publik (Facebook, Tëitter, etj.)
- ☐ Aplikacione për mesazhe të menjëhershme (ËhatsApp, Telegram, Signal, etj.)
- ☐ Tjetër:

Përcaktoni cilat kanale do të përdorni për të komunikuar me publikun më të gjerë (qytetarë që nuk janë drejtpërdrejt të përfshirë në procesin e pjesëmarrjes):

- ☐ Uebfaqe
- ☐ Mediat sociale
- ☐ Mediat tradicionale, si gazeta, televizioni, radio
- ☐ Materiale të printuara
- ☐ Mbledhje të hapura
- ☐ Tjetër:

Hapi 7: Zbatimi i procesit të pjesëmarrjes

Këshilla 1: Afatet kohore

Sa kohë mendoni se do të nevojitet për të zbatuar si duhet procesin tuaj të pjesëmarrjes?

Cilat janë hapat kryesorë dhe sa kohë zënë?

A përputhet koha e procesit të pjesëmarrjes me procesin e marrjes së vendimeve?

Këshilla 2: Burimet

Sa staf (i brendshëm/jashtëm) do t'ju duhet për zbatimin e procesit? Sa janë në dispozicion në organizatën tuaj?

Cili është buxheti juaj i parashikuar?

Çfarë burimesh teknike do të nevojiten për zbatimin e procesit? A mund të përdorni platforma ose mjete ekzistuese?

Këshilla 3: Partneritetet me aktorë joqeveritarë

Hartoni një listë të të gjitha partneriteteve potenciale me aktorë joqeveritarë që mund të mbështesin zbatimin e procesit tuaj të pjesëmarrjes.

Kë cilët aktorë mund të konsiderohen aleatë për të rritur ndikimin e procesit?

- ☐ Organizata të shoqërisë civile
- ☐ Subjekte të sektorit privat
- ☐ Akademia
- ☐ Media
- ☐ Tjetër:

Këshilla 4: Aksesueshmëria dhe përfshirja

A ka të gjithë mundësi të barabartë për të pasur akses dhe për të marrë pjesë? Mendoni për persona të ndryshëm si prindër, persona me aftësi të kufizuara, minoritete seksuale, etj.

Çfarë mund të bëhet për të rritur përfshirjen dhe aksesueshmërinë në procesin e pjesëmarrjes?

Këshilla 5: Të mendosh si qytetar

Rishikoni procesin e planifikuar nga këndvështrimi i një qytetari pjesëmarrës. Sigurohuni që çdo hap të jetë i qartë, i ftuar, dhe të krijojë besim dhe siguri. Disa pyetje udhëzuese:

- Si të rritet vetëdija për mundësinë e pjesëmarrjes?
- Si të kthehet vetëdija në interes?
- Si të kalojë nga interesi në pjesëmarrje aktive dhe angazhim?
- Si të mbahet angazhimi i pjesëmarrësve deri në fund të procesit?
- Si të sigurohet që ata të qëndrojnë të informuar për mënyrën se si kontributi i tyre ndikoi në vendimet publike?
- Si të ruhet interesi i tyre për mundësi të ardhshme?

Hapi 8: Përdorimi i kontributit të qytetarëve dhe dhënia e feedback-ut

Kush do t'i përgjigjet komenteve dhe rekomandimeve të pjesëmarrësve? Në çfarë forme do të bëhet kjo?

Si do ta njihni dhe vlerësoni punën e pjesëmarrësve?

Si do të komunikoni përgjigjen ndaj rekomandimeve? Dhe kur?

Hapi 9: Vlerësimi i procesit të pjesëmarrjes

Si do ta vlerësoni procesin e pjesëmarrjes? Kur do të ndodhë vlerësimi?

Çfarë metodash do të përdoren?

Çfarë kriteresh do të përdorni për vlerësim?

Kush do të jetë përgjegjës për vlerësimin?

Shtojca B: Modeli i procedurave të brendshme e një akti bashkiak që kalon në konsultim publik.

Hapat	Përshkrimi	Koha
Hapi 1. Administrata e bashkisë kalon aktin në konsultim.	Ide e paraqitur nga departamentet e saj (ose nga grupe interesi) që mbështetet në Planin e Përgjithshëm Vendor apo në strategjinë për zhvillim ekonomik për Bashkinë: a. Baza ligjore: Ligji Nr. 139/2015, Neni 18; Ligji Nr.107/2014; Ligji 146/2014 b. Përgatitet materiali për konsultim që duhet të jetë i thjeshtë dhe i kuptueshëm. c. Përgatiten prezantimet me PP ose edhe animime apo Video sipas rëndësisë. d. Bëhen njoftimet përmes: ✓ Faqes së internetit të Bashkisë; ✓ Media Lokale; ✓ Grupe interesi. Në këtë takim merren mendime nga qytetarët apo grupet e interesit të cilët ndihmojnë bashkinë për të rritur impaktin e ndërhyrjes apo shpenzimeve publike	Fillim i procesit
Hapi 2. Mendimet e qytetarëve	Mendimet e qytetarëve pas konsultimit trajtohen në administratë duke u konsultuar në grupin e strategjisë apo në departamentet përkatëse dhe dilet me një Projekt Vendim. <i>Koha: Jo me pak se 2 muaj para mbledhjes së Këshillit Bashkiak</i>	Minimum 2 muaj para mbledhjes se KB
Hapi 3. Projekt vendimi shkon në Këshillin Bashkiak	a. Sekretari i këshillit e delegon në komisionin përkatës. b. Komisioni përkatës autorizon sekretarin e Këshillit që të organizojë takimet e Këshillit Bashkiak për konsultimin Publik. ✓ Sipas territorit; ✓ Sipas grupeve të interesit; <i>Koha: Një muaj para mbledhjes së Këshillit Bashkiak</i>	1 muaj para mbledhjes se KB
Hapi 4. Konsultim me Publikun nga Këshilli Bashkiak	Bëhet njoftimi përmes: ✓ Medias lokale; ✓ Ndërlidhësit komunitar apo Kryetarët e fshatrave si dhe struktura të tjera komunitare sipas tipit të projekt vendimit; ✓ Faqes së internetit të Bashkisë; ✓ Rrjete sociale. b. Nëqoftëse është një projekt vendim shume i rëndësishëm tërhiqet mendim edhe me anë të aplikacioneve (IT) ose në faqe ëeb ku për variantet e paraqitura qytetarët shprehin qëndrimet e tyre.	Sipas planit të komisionit
Hapi 5. Mendimet e qytetarëve pas konsultimit publik	Mendimet e Qytetareve pas konsultimit publik të projekt vendimit i kalohen Kryetarit Bashkise dhe Kryesisë së Këshillit	Pas konsutimit publik
Hapi 6. Komisioni përkatës përpilon raportin për Projekt Vendimin	Komisioni përkatës përpilon raportin ër projekt vendimin dhe ja kalon sekretarit të Këshillit Bashkiak. Koha në dispozicion 2-3 javë para mbledhjes së Këshillit.	2-3 javë para mbledhjes së KB
Hapi 7. Kryesia e Këshillit autorizon sekretarin të përgatis materialet.	Kryesia e këshillit pasi ka miratuar rendin e ditës së mbledhjes së këshillit, autorizon sekretarin e këshillit që të përgatisë materialet, ndër të tjera Projekt Vendimin e konsultuar së Bashku me relacionet	10 ditë para

	përkatëse (gjatë kësaj kohe, ka hapësire për reflektim nga administratë në lidhje me sugjerimet apo reagimet e komunitetit).	mbledhjes së KB
	Koha: 10 ditë para mbledhjes së Këshillit Bashkiak	
Hapi 8. Diskutimi dhe miratim në KB	Projekt Vendimi kalon në KB për diskutim dhe miratim.	Jo më vonë se 5 ditë
Hapi 9. Shpallja e vendimit	Shpallja realizohet menjëherë pas miratimit nga Prefekti	Pas miratimit zyrtar
Baza ligjore: - Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, - Ligji Nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”; - Ligji Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik:		

Shtojca C: Fletë Kontrolli për Pjesëmarrjen Publike në nivel vendor

Kjo fletë kontrolli ndihmon bashkitë të përmbushin detyrimet ligjore të konsultimit publik si pjesë e proceseve të vendimmarrjes dhe planifikimit. Ajo është në përputhje me kuadrin ligjor shqiptar, përfshirë Ligjin nr. 139/2015, Ligjin nr. 146/2014, Ligjin nr. 119/2014, Kodin e Procedurave Administrative, si dhe praktikën e Konventës së Aarhus-it.

Nr.	Kriteri ligjor dhe praktik	Po	Jo	Shënime / Referenca
1.1	A është identifikuar qartë çështja që kërkon konsultim publik sipas ligjit nr. 146/2014, neni 4?			
1.2	A është përgatitur një shkresë zyrtare për fillimin e konsultimit dhe krijuar një plan i konsultimit publik (data, format, përgjegjësit)?			
1.3	A është përcaktuar natyrshëm niveli i pjesëmarrjes: informim, konsultim apo bashkëvendimmarrje?			
1.4	A është respektuar afati minimal 20 ditë pune për periudhën e konsultimit (ligji 146/2014, neni 7)?			
2.1	A është publikuar njoftimi për konsultimin në faqen zyrtare të bashkisë dhe në ambientet publike?			
2.2	A janë ofruar materialet shpjeguese në një gjuhë të kuptueshme për publikun (jo vetëm teknikisht)?			
2.3	A është ndarë informacioni për mënyrën e dërgimit të komenteve dhe pjesëmarrjes (e-mail, dorazi, online)?			
3.1	A është hartuar një listë me grupet e interesit dhe komunitetet që ndikohen nga vendimmarrja?			
3.2	A janë marrë masa që pjesëmarrja të jetë gjithëpërfshirëse (gra, të rinj, minoritete, OSHC, biznes)?			
3.3	A është mundur aksesimi për persona me aftësi të kufizuara dhe pjesëmarrës të marginalizuar?			
4.1	A është zhvilluar konsultimi në format të hapur dhe në vendin ku ndikohet vendimmarrja (subsidiariteti)?			
4.2	A janë përdorur metoda të ndryshme (dëgjesa, forume, pyetësorë, konsultime online)?			
4.3	A është mbajtur procesverbal i konsultimit dhe janë dokumentuar komentet e marra?			

5.1	A janë shqyrtuar të gjitha komentet e marra dhe përmbledhur në një raport përmbledhës të konsultimit?			
5.2	A janë integruar komentet në draftin përfundimtar dhe është dokumentuar arsyetimi për pranimin / refuzimin e tyre?			
5.3	A është publikuar raporti përfundimtar i konsultimit në faqen zyrtare dhe shpërndarë te grupet e interesit?			
6.1	A janë respektuar parimet e proporcionalitetit, ligshmërisë, mosdiskriminimit dhe arsyetimit të vendimit?			
6.2	A është e dokumentuar në mënyrë të rregullt çdo hap i procesit si pjesë e dosjes administrative?			
7.1	A është zhvilluar një vetëvlerësim i procesit për të identifikuar përmirësime për konsultimet e ardhshme?			
7.2	A janë ruajtur të gjitha dokumentet për transparencë dhe auditim të mundshëm ligjor?			

Shtojca D: Kuti Studimore për bashkëpunimin e bashkive për shpalljen e biokorridor-it si Park Natyror Bashkiak

KUTI STUDIMORE: Bashkëpunimi i Bashkive për Shpalljen e Biokorridorit si Park Natyror Bashkiak	Bashkitë nuk kanë të drejtë ligjore për të shpallur zona të mbrojtura ose për të përcaktuar vetë kufijtë e korridoreve ekologjike. Këto janë kompetenca qëndrore të përcaktuara nga kuadri kombëtar i mjedisit. Për këtë arsye, kapaciteti i bashkive për të ndikuar në mënyrë efektive në menaxhimin e korridoreve ekologjike varet nga bashkëpunimi me aktorë të tjerë, ndërveprimi institucional dhe përfshirja aktive e komunitetit lokal. Në këtë drejtim, bashkitë mund të luajnë rol të rëndësishëm si lehtësues të pjesëmarrjes publike, si edhe si zëdhënës të interesave të komuniteteve në vendimmarrje për territorin dhe mjedisin. Në kuadrin ligjor shqiptar, bashkitë luajnë një rol thelbësor në planifikimin dhe menaxhimin e territorit, çka ndikon drejtpërdrejt në funksionalitetin dhe ruajtjen e këtyre korridoreve. Sipas Ligjit nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, bashkitë janë përgjegjëse për hartimin dhe miratimin e Planeve të Përgjithshme Vendore (PPV), të cilat përfshijnë përcaktimin e përdorimit të tokës dhe të zonave me vlera natyrore, përfshirë ato që kontribuojnë në ruajtjen e lidhjeve ekologjike. Përmes PPV-ve, bashkitë kanë mundësi të identifikojnë dhe të ruajnë hapësira natyrore që funksionojnë si korridore ekologjike, duke ndikuar në zhvillimin e qëndrueshëm të territorit. Ky rast studimor shpjegon hapat e koordinuar që bashkitë, të cilat ndodhen në territorin e një biokorridori ekologjik, duhet të ndjekin për të propozuar dhe shpallur këtë zonë si Park Natyror Bashkiak. Procesi mbështetet në legjislacionin shqiptar aktual mbi zonat e mbrojtura, planifikimin territorial dhe pjesëmarrjen publike.
Hapi 1: Hartimi i studimit fizibilitetit të biokorridorit	Bashkitë duhet të bashkëpunojnë për të zhvilluar një studim të detajuar fizibiliteti, i cili përfshin: - Përcaktimin e kufijve të biokorridorit dhe zonave kryesore me vlera ekologjike dhe biodiversiteti. - Identifikimin e ndikimeve sociale dhe ekonomike që mund të sjellë shpallja e zonës si park natyror. - Mbështetjen në të dhëna nga Administratat Rajonale të Zonave të Mbrojtura (AZM), si inventarizimi i habitatëve, specieve të mbrojtura dhe zonave prioritare për ruajtje. Referencat ligjore: Ligji Nr. 81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura në Republikën e Shqipërisë”, Nenet 10 dhe 11: përcaktimi dhe vlerësimi i zonave të mbrojtura dhe kërkesat për studime fizibiliteti.]
Hapi 2: Integrimi i biokorridorit në Planet e Përgjithshme Vendore (PVV)	Në kuadër të përditësimit të PPV-ve, bashkitë duhet të përfshijnë zonën e biokorridorit si një njësi funksionale me status të veçantë “Park Natyror Bashkiak”. Kjo nënkupton: – Projektimin e zonës me kufizime të qarta në përdorimin e tokës, duke siguruar masa mbrojtëse për habitatet dhe komunitetet. – Kërkesën e miratimit nga këshillat bashkiakë për PPV-në e përditësuar që përfshin këtë status. Ky hap garanton bazën ligjore dhe planifikimin e qëndrueshëm të territorit. Referencat ligjore: Ligji Nr. 139/2015 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, Nenet 8 dhe 9: procesi i hartimit dhe miratimit të PPV-së dhe përfshirja e zonave të veçanta.

Hapi 3: Organizimi i Konsultimeve publike dhe me grupet e interesit	Për të garantuar transparencën dhe pjesëmarrjen aktive të komunitetit, duhet të zhvillohen konsultime lokale. – Me fermerët, organizatat joqeveritare mjedisore, bizneset turistike dhe përfaqësues të komuniteteve lokale. – Për diskutimin e kufijve, rregullave të përdorimit dhe shërbimeve që do të ofrohen në park. Këto konsultime janë thelbësore për të forcuar legjitimitetin e procesit dhe për të inkorporuar interesat dhe nevojat reale të banorëve dhe aktorëve lokalë. [Ligji 146/2014; neni 16] Referenca ligjore: Ligji Nr. 119/2014, Neni 5; Ligji Nr. 146/2014, Neni 16: pjesëmarrja e publikut në vendimmarrje për çështje mjedisore.
Hapi 4: Paraqitja e kërkesës zyrtare për shpallje	Pas përfundimit të studimit, miratimit të PPV-së dhe konsultimeve, bashkitë duhet të dorëzojnë një kërkesë të përbashkët pranë: – Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, si autoriteti qendror përgjegjës për politikën mjedisore dhe turizmin. – Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM), e cila sipas Ligjit Nr. 81/2017 ka mandatin për shpalljen dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura. Dokumentacioni duhet të përfshijë studimin fizibilitetit, versionin përditësuar të PPV-së dhe referatat e konsultimeve publike. Referencat Ligjore: Ligji 81/2017; neni 18,20 kompetencat dhe procedurat e autoriteteve për shpalljen e zonave të mbrojtura.
Hapi 5: Zbatimi i planit të menaxhimit dhe koordinimi i mirëmbajtjes	Pas miratimit zyrtar, bashkitë duhet të hartojnë dhe zbatojnë një plan menaxhimi vjetor për parkun natyror bashkiak, i cili përfshin: – Rolin e bashkëpunimit mes bashkive për mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe monitorimin e zonës. – Bashkëpunimin me AZM-të dhe komunitetet lokale për mbrojtjen e biodiversitetit dhe zhvillimin e aktiviteteve edukative dhe promovuese. – Krijimin e mekanizmave të përbashkëta për zgjidhjen e sfidave operative dhe përmirësimin e qëndrueshmërisë së parkut. Referenca ligjore: Ligji 81/2017; nenet 22, 58 kërkesat për menaxhimin e zonave të mbrojtura dhe rolet e autoriteteve lokale dhe qendrore.

SHTOJCA E

Përmbledhje e sugjerimeve të mbledhura gjatë konsultimit publik mbi draft-udhëzuesin për pjesëmarrjen publike në nivel lokal.

E.1 Qëllimi dhe konteksti i konsultimit

Kjo shtojcë paraqet një përmbledhje të strukturuar të sugjerimeve, komenteve dhe gjetjeve të mbledhura gjatë takimit konsultues mbi draft-udhëzuesin për pjesëmarrjen publike në nivel lokal. Konsultimi u zhvillua me qëllim përmirësimin e cilësisë së dokumentit dhe forcimin e zbatueshmërisë së tij praktike në nivel vendor, veçanërisht në kontekstin e menaxhimit të korridoreve ekologjike dhe çështjeve mjedisore me interes publik.

Sugjerimet e mbledhura pasqyrojnë përvojat konkrete dhe perspektivat e aktorëve të përfshirë drejtpërdrejt në proceset e konsultimit publik dhe shërbejnë si bazë reflektuese për përmirësimin e udhëzuesit.

E.2 Profili i aktorëve pjesëmarrës në konsultim

Në procesin konsultues morën pjesë përfaqësues të këtyre grupeve kryesore aktorësh:

- Bashki dhe struktura të vetëqeverisjes vendore
- Administrata të Zonave të Mbrojtura (AdZM)
- Organizata të shoqërisë civile (OSHC)
- Përfaqësues të komuniteteve lokale dhe aktorë të interesit

Këto grupe kontribuan me përvoja praktike, shembuj konkretë dhe vlerësime kritike mbi funksionimin aktual të proceseve të pjesëmarrjes publike në nivel lokal.

E.3 Praktika të mira të identifikuar gjatë konsultimit

Gjatë diskutimeve u evidentuan disa praktika pozitive ekzistuese, të cilat përbëjnë një bazë të rëndësishme për forcimin e pjesëmarrjes publike:

- Ekzistenca e një kuadri ligjor të konsoliduar për njoftimin dhe konsultimin publik, i cili përdoret si referencë nga bashkitë;
- Zhvillimi i konsultimeve publike për buxhetin vjetor nga bashkitë dhe këshillat bashkiakë;
- Roli i njësive administrative dhe kryesive të fshatrave në informimin e komuniteteve lokale, veçanërisht në bashkitë e vogla;

- Organizimi i takimeve informuese dhe ndërgjegjësuere nga administratat e zonave të mbrojtura për çështje që lidhen me menaxhimin e territorit;
- Vetë-përfshirja e qytetarëve në çështje që i prekin drejtpërdrejt, veçanërisht në rastet e ndikimeve mjedisore lokale.

Këto praktika tregojnë se ekzistojnë elementë funksionalë të pjesëmarrjes publike, por ato mbeten të fragmentuara dhe jo gjithmonë të institucionalizuara.

E.4 Sfidat dhe problematikat kryesore të raportuara

Pjesëmarrësit në konsultim identifikuan një sërë sfidash të përsëritura në zbatimin praktik të konsultimit publik në nivel vendor, ndër të cilat:

- Zhvillimi i konsultimeve publike në faza të vona të projekteve, kur vendimmarrja është në thelb e përfunduar;
- Mungesa e gjithëpërfshirjes reale, për shkak të përzgjedhjes paraprake të pjesëmarrësve në konsultime;
- Mungesë transparence mbi mënyrën se si sugjerimet e qytetarëve reflektohen ose jo në vendimmarrje;
- Njoftimi i konsultimeve kryesisht përmes rrjeteve sociale, pa garantuar informim të barabartë për të gjithë komunitetin;
- Mungesë infrastrukture dhe kapacitetesh logjistike për organizimin e konsultimeve cilësore;
- Zhvillimi i projekteve me ndikim të lartë mjedisor pa konsultime publike të mirëfillta ose me konsultime formale.

Këto problematika ndikojnë negativisht në besueshmërinë e procesit të konsultimit publik dhe në perceptimin e qytetarëve mbi rolin e tyre në vendimmarrje.

E.5 Propozime për përmirësim të procesit të pjesëmarrjes publike

Në kuadër të konsultimit u paraqitën një sërë rekomandimesh për përmirësimin e praktikave ekzistuese, ndër të cilat:

- Zhvillimi i konsultimeve publike që në fazat e hershme të planifikimit të projekteve, planeve dhe politikave;
- Përdorimi i një game më të gjerë kanalesh komunikimi për njoftimin e konsultimeve, përfshirë mediat lokale dhe strukturat komunitare;
- Rritja e bashkëpunimit ndërinstitutional, veçanërisht ndërmjet bashkive dhe institucioneve përgjegjëse për mjedisin;
- Përmirësimi i transparencës mbi hapat e procesit të konsultimit dhe mënyrën e trajtimit të komenteve të marra;

- Forcimi i rolit të komunitetit lokal si partner aktiv në vendimmarrje dhe jo vetëm si subjekt formal konsultimi.

E.6 Reflektimi i sugjerimeve në udhëzues

Sugjerimet e mbledhura gjatë konsultimit janë reflektuar në mënyrë selektive në trupin e udhëzuesit, në përputhje me natyrën e tij metodologjike dhe orientuese. Konkretisht:

- Janë forcuar referencat mbi rëndësinë e konsultimeve të hershme dhe gjithëpërfshirëse;
- Janë theksuar gabimet e shpeshta që duhen shmangur në proceset e konsultimit publik;
- Janë zgjeruar rekomandimet praktike mbi mjetet dhe kanalet e informimit të komunitetit;
- Është ruajtur kjo shtojcë si instrument dokumentues për transparencë dhe gjurmueshmëri të procesit konsultues.

Kjo qasje synon të sigurojë një ekuilibër ndërmjet integritit të mësimave kryesore në udhëzues dhe ruajtjes së natyrës reflektuese dhe jo-normative të sugjerimeve të mbledhura.

TERMINOLOGJIA

Kushtetuta e Republikës e së Shqipërisë, ka sanksionuar se qeverisja vendore ngrihet në bazë të parimit të decentralizimit të pushtetit dhe ushtrohet sipas parimit të autonomisë vendore. Njësitë e vetëqeverisjes vendore janë bashkitë dhe qarqet, të cilat realizojnë vetëqeverisjen vendore në Republikën e Shqipërisë. Bashkia është njësi bazë e vetëqeverisjes vendore dhe përfaqëson një unitet administrativo territorial dhe bashkësi banorësh. Bashkitë, shtrirja territoriale, emri dhe qyteti qendër i saj përcaktohen me ligj.

Bashkia	përbëhet nga disa njësi administrative, sipas lidhjeve tradicionale, historike, ekonomike dhe sociale.
Njësitë administrative	në territorin e një bashkie (ish Komunat), shtrirja e tyre territoriale dhe emri përcaktohen me ligj. Njësitë administrative përbëhen nga qytetet dhe/ose fshatrat. Shtrirja territoriale, emri i qyteteve dhe fshatrave, pjesë e çdo njësie administrative, përcaktohen me ligj.
Konsultimi	është proces institucional këshillimi ndërmjet qytetarëve, qeverisjes qendrore dhe vetëqeverisjes vendore, transparent dhe i drejtpërdrejtë, për informimin, këshillimin e shkëmbimin e opinioneve për politikën, legjislativonin e normat që rregullojnë vetëqeverisjen vendore, i cili zhvillohet rregullisht dhe në mënyrë të vazhdueshme, sipas procedurave dhe një strukture të përcaktuar.
Koordinatori	për të drejtën e informimit dhe transparencës është nëpunësi civil i caktuar brenda strukturës së Bashkisë përkatese për të asistuar qytetarët të aksesojnë informacionin dhe ndihmojnë në vendimmarrje. ²⁰
Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik Korridoret ekologjike	, është nëpunësi civil i caktuar për bashkërendimin dhe administrimin e përgjithshëm të punës për garantimin e së drejtës së njoftimit e të konsultimit publik. ²¹ janë zona që mundësojnë lëvizjen e specieve dhe lidhen me mbrojtjen e biodiversitetit dhe zhvillimin rural. ²² Korridoret ekologjike janë hapësira territoriale që sigurojnë lidhjen ndërmjet zonave me vlera të larta natyrore (qendra ekologjike), duke mundësuar lëvizjen, përhapjen dhe mbijetesën e specieve në një mjedis gjithnjë e më të fragmentuar nga aktivitetet njerëzore.
Koncepti i rrjetit ekologjik	ndërthur këto qendra dhe korridore ekologjike në një tërësi funksionale që siguron vazhdimësinë ekologjike të zonës dhe elasticitetin e saj ndaj presioneve mjedisore, përfshirë ndryshimet klimatike, ndotjen apo ndërtimet e pakontrolluara.
Palët e interesuara	: çdo palë e interesuar dhe/ose e prekur, përfshirë institucione dhe organizata, qofshin ato qeveritare apo joqeveritare, nga shoqëria civile, academia, media apo sektori privat.
Qytetarët:	individë, pavarësisht moshës, gjinisë, orientimit seksual, përkatësisë fetare apo politike. Termi përdoret në kuptimin më të gjerë si “banor i një vendi të caktuar”, që mund të jetë një fshat, qytet, bashki, rajon, shtet apo vend, në varësi të kontekstit. Nuk përdoret në kuptimin më të ngushtë si “një shtetas i njohur ligjërisht i një shteti”.

²⁰ (Kuvendi, Ligji nr.119/2014, "Për të drejtën e informimit", 2014), neni 2

²¹ (Kuvendi, Ligji nr.146/2014, "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik", 2014), neni 10

²² (Qirjo, 2024)